



**KONTROLLI I LARTË SHTETI**



# **RAPORT PËRFUNDIMTAR**

**PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**

**“ENTIN RREGULLATOR TË UJIT”**

**Tiranë, 2020**



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**(Auditim Përputhshmërie)**

**“Enti Rregullator i Ujit”**

**Nëntor, 2020**



**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**(Auditim Përputhshmërie)**

**“Enti Rregullator i Ujit”**

<b>Nr</b>	<b>Përmbatja</b>	<b>Faqe</b>
	<b>I.Përmbledhje Ekzekutive</b>	<b>3-4</b>
	<b>II.HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)</b>	
a)	Objektivat dhe qëllimi .....	4
b)	Identifikimi i çështjes.....	5
c)	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese .....	5
d)	Përgjegjësitë e audituesve.....	5-6
e)	Kriteret e vlerësimit.....	6
f)	Standardet e auditimit.....	6
	<b>III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....</b>	<b>7</b>
	<b>A. OPINIONI I AUDITIMIT.....</b>	<b>7-8</b>
	<b>IV. DREJTIMET E AUDITIMIT</b>	
1.	Organizimi dhe funksionimi i ERRU.....	8-12
2.	Zbatimi i dispozitave ligjore për marëdhëniet e punës dhe pagave.....	12-15
3.	Financimi dhe Zbatimi i Buxhetit të ERRU.....	15-23
4.	Zbatimi i dispozitave ligjore për dministrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....	23-25
5.	Zbatimi i dispozitave ligjore për pajisjen me licenca të personave fizik dhe juridik dhe përcaktimi i tarifave të licencimit.....	25-30
6.	Zbatimi i dispozitave ligjore për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave të shitjes së ujit me pakicë e shumicë, të ujrave të përdorur dhe trajtimit të tyre .....	30-33
7.	Prokurimet e fondeve publike.....	33-37
8.	Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit të çdo drejtorie në veçanti dhe të ERRU-së në tërësi.....	38-47
	<b>V. GJETJE DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>47-48</b>
	<b>VI.ANEKSE .....</b>	<b>49-54</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

### I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

#### I/a. Përshkrim i shkurtër i Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi “Entin Rregullator të Ujit” (ERRU), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme, ndër të tjera, çështjeve që lidhen me:

1. Organizimi dhe funksionimi i ERRU
2. Hartimin dhe zbatimin e buxheti
3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare
4. Zbatimi i dispozitave ligjore për pajisjen me licenca të personave fizik dhe juridik dhe përcaktimi i tarifave të licencimit
5. Zbatimi i dispozitave ligjore për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave të shitjes së ujit me pakicë e shumicë, të ujrave të përdorur dhe trajtimit të tyre
6. Prokurimet e fondeve publike
7. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit

#### I/b. Përshkrim i përmblendhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

R	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga auditimi konstatohet se problematikë në licencim është mos pajisja me akt miratim Higjeno - Sanitar për të gjithë zonat e shërbimit, duke çuar në vonesa në procedurën e pajisjes me licencim dhe gjithashtu garancisë së sigurisë së shëndetit publik për uljen e rrishtit të kontaminimit të rrjeteve shpërndarëse të ujësjellësit, pasi edhe duke mos e pasur këtë licencë dhe deri në momentin e marrjes së saj UK e zhvillojnë aktivitetin e tyre .		MESEM	Ministria e Shëndetësisë duhet të marrë masa për hartimin e akteve të nevojshme ligjore dhe nënligjore për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjeno Sanitar për shoqëritë UK, si dhe të rregullores së Inspektiveve Higjeno Sanitare për sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura. Hartimi i nënakteve të mësipërme do ti shërbejë rritjes së garancisë së sigurisë së shëndetit publik.
2	Nga auditimi mbi plotësimin e organikës së ERRU-së zbatim të vendimit nr.34/2016 të Kuvendit “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, rezultoi se për periudhën deri më 30.04.2020, organika është e paplotësuar me 3 punonjës më pak		MESEM	ERRU të marrë masat dhe të fillojë procedurat për rekrutimin e stafit në pozicionet vakante sipas strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës .



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

3	<p>Nga auditimi u konstatua se dosjet e procedurave të licensimit të personave fizik e juridik dhe dosjet e përcaktimit të çmimeve dhe tarifave të shitjes së ujit me pakicë dhe shumicë të ujrave të përdorur dhe trajtimit të tyre nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat.</p> <p>-Dosjet personale të nëpunësve nuk janë inventarizuar, administruar me indeks të vecantë, sipas VKM Nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", Formatit Standard nr.17, ku evidentohen shkresat e fashikujt në vecanti si dhe pasqyrimi kronologjik i numrit të fletëve në dosje.</p>		MESEM	<p>ERRU të marrë masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve të të gjitha procedurave të licensimit dhe e përcaktimit të çmimeve dhe tarifave dhe dosjeve personale të nëpunësve.</p>
4	<p>Nga auditimi i procedurave të blerjeve të vogla konstatohet se nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël kërkohet që OE fitues të sjellin mostra për secilin produkt në momentin e paraqitjes në institucion në kundërshtim me pikën 8 të Udhëzimit nr 3 datë 08.01.2018 "Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël autoriteti kontraktor nuk duhet të kërkojë paraqitjen e mostrave të mallit objekt prokurimi, pasi verifikimi i cilësisë së mallit bëhet në momentin e marrjes së mallit në dorëzim"</p>		MESEM	<p>Nga anëtarët e Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël të merren masa në procedurat e blerjeve të vogla verifikimi i cilësisë së mallit të bëhet në momentin e marrjes së mallit në dorëzim, dhe të mos kërkohet paraprakisht paraqitja e mostrave.</p>

#### I. Hyrja.

Mbështetur në Ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH", në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.393/1, datë 30.04.2020, në Entin Rregullator të Ujit, Tiranë, nga data 30.04.2020 – 20.06.2020, për periudhën nga 01.01.2018 deri në 30.04.2020, u krye auditimi i Përputhshmërisë në ERRU, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. Erjola Meçaj (*përgjegjës grupi*),
2. Prishila Rama, anëtar
3. Hektor Kosova, anëtar
4. Gentiana Shata, anëtar

#### a) Titulli:

Raporti Përfundimtar i Auditimit të Përputhshmërisë në Entin Rregullator të Ujit(ERRU)

#### b) Marrësi:

Ky Raport Përfundimtar i adresohet Kryetarit të Komisionit Kombëtar Rregullator, Z.Ndriçim Shani

### METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

#### a) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

**Objektivat specifike të auditimit** është përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit, Enti Rregullator i Ujit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

**Qëllimi i auditimit** është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Enti Rregullator i Ujit, Tiranë.

#### **b) Identifikimi i çështjes:**

Misioni i ERRU është të sigurojë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

Të rregullojë shërbimin në sektorin e ujësjellës-kanalizime në Shqipëri, në përputhje me mandatin tonë ligjor dhe synimin për të arritur nivelin më të lartë në rolin tonë rregullator.

ERRU është institucion publik i pavarur që bën rregullimin e sektorit ujësjellës kanalizime në Shqipëri, i krijuar me ligjin 8102 dt. 28.03.1996, i ndryshuar, për të siguruar garantimin dhe mbrojtjen e interesave publike dhe për të krijuar një mjedis rregullator transparent.

Licensojnë persona fizikë apo juridikë, që ofrojnë shërbimin ujësjellës-kanalizime për përfitim publik;

Sigurojnë që operatorët t'ju ofrojnë konsumatorëve shërbime me cilësi të mirë dhe efikase dhe me një çmim të arsyeshëm;

Përcaktojnë tarifën e shërbimit, në mënyrë që të sigurojnë qëndrueshmërinë financiare të operatorëve si dhe përbalimin e tyre nga klientët;

Monitorojnë performancën e operatorëve duke siguruar zbatimin e masave për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe duke nxitur progresin e vazhdueshëm të shërbimit, përmes vendosjes së objektivave efikase dhe sfidues;

Sigurojnë që operatorët bëjnë më të mirën për klientët dhe mjedisin në vështrim afatgjatë;

Analizojnë ankesat e konsumatorëve dhe i mbështesin ata në zgjidhjen e tyre ndërmjet konsumatorëve dhe operatorëve;

Kontribuojnë me komentet tona në të gjitha proceset e rëndësishme në sektor si në hartimin e strategjive, politikave dhe legjislacionit kombëtar për sektorin ujësjellës kanalizime;

Rregullisht hartojnë dhe vënë në dispozicion informacion mbi sektorin ujësjellës kanalizime për të gjithë aktorët në sektor dhe publikun e gjerë p.sh. përmes raporteve Vjetore dhe të Performancës.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr.393/1, datë 30.04.2020.

#### **c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:**

Drejtimi i Entit Rregullator të Ujit është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafit menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **d) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:**

Raporti i auditimit duhet të deklarojë që përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar mbi auditimin. Raporti i auditimit duhet të shprehë që auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Gjithashtu, raporti i audituesit duhet të shpjegojë që këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale. Raporti i audituesit duhet të përshkruajë një auditim duke u shprehur se: Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për marrjen e evidencës së auditimit në lidhje me shumatat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare; Procedurat e auditimit të zgjedhura janë në varësi të gjykimit të audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e risqeve të anomalive



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

materiale në pasqyrat financiare, të cilat mund të vijnë si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Në vlerësimin e këtyre risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm lidhur me përgatitjen e pasqyrave financiare të subjektit në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit. Në rrethanat kur audituesi ka edhe përgjegjësinë për të shprehur një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm, në lidhje me 54 auditimin e pasqyrave financiare, audituesi duhet të mos shkruajë fjalinë, që marrja në konsideratë e kontrollit të brendshëm nga audituesi nuk ka si qëllim shprehjen e një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm; dhe Auditimi gjithashtu, përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi si edhe paraqitjen e përgjithshme të pasqyrave financiare. Kur pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, përshtatshmi i auditimit në raportin e audituesit duhet t'i referohet "përgatitjes dhe paraqitjes së drejtë të pasqyrave financiare të subjektit" ose "përgatitjes së pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë", që është e përshtatshme sipas rrethanave. Raporti i audituesit duhet të shprehë se audituesi beson që evidenca e auditimit e marrë

#### **e) Kriteret e vlerësimit:**

- Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, i ndryshuar "Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura"
- Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008, "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve", i ndryshuar
- Ligji nr. 9875, datë 14.02.2008, "Për Metrologjinë", i ndryshuar
- Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike"
- Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike"
- Ligji nr. 11/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"
- Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"
- Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"
- Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"
- Ligji nr. 71-2018, datë 18.10.2018, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*";
- UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar.
- Ligjit nr. 109, datë 30.11.2017 "Për buxhetin e vitit 2018",
- UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Ligjit nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019",
- Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", i ndryshuar;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

#### **f) Standardet e Auditimit**

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

- ISSAI 100 (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë"



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

-INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”; INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”;

## II. PËSHKRIMI AUDITIMIT

### 1. Informacioni i përgjithshëm

ERRU është krijuar në vitin 1998, në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 i ndryshuar. ERRU një institucion publik i pavarur dhe është drejtpërdrejt përgjegjës ndaj Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë, të cilëve u raportojnë rregullisht nëpërmjet Raportit Vjetor, dorëzuar në Janar. Këshilli i Ministrave nëpërmjet Ekipit Përzgjedhës pas një procesi selektiv emëron Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR).

Struktura organizative e ERRU është miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr.34/2016. KKRR përbëhet nga Kryetari i ERRU i cili është drejtuesi ekzekutiv dhe nga katër anëtarë. KKRR mbledhet rregullisht gjatë gjithë vitit për të marrë vendime lidhur me të gjithë funksionet dhe detyrat e ERRU.

### 2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- Objekt i këtij auditimi është auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së ERRU-së me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore të institucionit

- Qëllimi i auditimit: Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Enti Rregullator i Ujit, Tiranë.

- Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i aktivitetit të ERRU me qëllim dhënien e opinionit, shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Janë audituar dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin për periudhën 01.01.2018-30.04.2020, ku janë mbuluar me auditim fondet e buxhetit të shtetit, si dhe janë audituar me përzgjedhje dosjet sipas programit për periudhën objekt auditimi.

## A. OPINIONI I AUDITIMIT

### Baza mbi opinionin e përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs) mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së.

*Nga auditimi mbi përputhshmërinë* sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Enti Rregullator i Ujit, të rregullave, ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në procedurat e audituara të prokurimit në sistemin elektronik së bashku me dokumentacionin mbi përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit, pajisjen me licenca të personave fizik dhe juridik, zbatimin e dispozitave ligjore për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave të shitjes së ujit me pakicë dhe shumicë, të ujrave të përdorur dhe trajtimit të tyre u evidentuan në përgjithësi zbatimin e tyre, por edhe disa raste vakume të kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, të cilat kryesisht, konsistojnë në procedura administrative lidhur me menaxhimin e dosjeve, procedurat e rekrutimit të stafit , procedurat e prokurimit.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

### **Opinion i pakualifikuar<sup>1</sup>,**

Nën gjykimin e grupit të auditimit, në lidhje me auditimin e përputhshmërisë shpreh një konkluzion/opinion të pakualifikuar me theksim çështje, ku në gjykimin profesional, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje nuk kanë devijime materiale.

### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:**

Drejtimi i Entit Rregullator të Ujit është përgjegjës për përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit dhe pajisjen me licenca të personave fizik dhe juridik, zbatimin e dispozitave ligjore për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave të shitjes së ujit me pakicë dhe shumicë, të ujërave të përdorur.

### **Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:**

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Entit Rregullator të Ujit, me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

### **III. DREJTIMET E AUDITIMIT:**

#### **1. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ERRU**

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është institucion i pavarur publik, i cili e bazon veprimtarinë e tij në aktet ligjore dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre si më poshtë:

- Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102);
- Ligji nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” (ligji nr. 120/2016);
- Ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar (ligji nr. 9902);
- Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121);
- Ligj nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë (Kodi i Procedurës Administrative);
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Kodi i Punës);
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (ligji nr. 10296);
- Ligji nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” (ligji nr. 9584);

<sup>1</sup> Sipas Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, kapitulli V, pika 5.4, Konkluzionet/ opinionet e pa kualifikuara: Kur audituesi nuk ka raste mospërputhjes materiale për të raportuar, kur konkludon ai shpreh një konkluzion të pamodifikuar: Në rastin e angazhimit me siguri të arsyeshme, që informacioni mbi çështjen dhe objektin e auditimit është përgatitur në çdo aspekt material në përputhje me kriteret e vlerësimit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

• Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” (ligji nr. 8480).

-Mbështetur në nenin 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr.9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimin e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), është nxjerrë Vendimi nr.34/2016, datë 28.04.2016, mbi bazën e të cilit është krijuar struktura, orkanika, organizimi i brendshëm i ERRU të pasqyruara në Rregulloren e Brendshme me nr. 16, datë 28.04.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Entit Rregullator të Ujit dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, rregullore me të cilën institucioni ka funksionuar në vijimësi. Nga përmbajtja e rregullores së Brendshme, rezulton se janë evidentuar qëllimi, misioni dhe veprimtaria si dhe detyrat kryesore që duhet të përmbushë institucioni. Gjithashtu në këtë rregullore janë evidentuar detyrat specifike që duhet të kryejë secili prej pozicioneve të punës , detyrat dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Komisionit, Sekretarit të Komisionit dhe Kryetarit, Drejtorisë Tekniko-Ekonomike, Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është institucion i pavarur publik, i cili e bazon veprimtarinë e tij në aktet ligjore dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre si më poshtë:

ERRU është ngritur dhe funksionon në bazë të ligjit nr.8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura“, i ndryshuar. Qëllimi kryesor i ligjit nr.8102 është mbrojtja e interesave publike dhe krijimi i një mjedisi transparent dhe ligjor në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura. Lidhur me legjislacionin ku ERRU duhet të ushtrojë përgjegjësitë e veta ligjore, përmendim: Ligji nr.120/2016:“Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” , ka për qëllim të lehtësojë e nxisë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, duke promovuar përdorimin e përbashkët të infrastrukturës fizike ekzistuese dhe një zhvillim më efikas të infrastrukturës fizike të re, nëpërmjet ndërtimit të rrjeteve të shpejtësisë së lartë me kosto më të ulët, reduktimit të procedurave, si dhe sigurimit të së drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë. Në rastet kur lindin mosmarrëveshje mbi refuzimin e aksesit apo termat dhe kushtet specifike, duke përfshirë edhe çmimin, ERRU është autoriteti përgjegjës për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve, kur aksesit është kërkuar nga një sipërmarrës i komunikimit elektronik. Gjithashtu, ligji nr.71/2018: “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve” (i ndryshuar), parashikon ngritjen pranë ERRU të një strukture për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve mes konsumatorëve dhe operatorëve për veprimtaritë në fushën e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

#### **- Respektimi i strukturës organike të miratuar.**

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se struktura dhe organika e ERRU-së rregullohen në përputhje me ligjin nr.9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”. Si institucion i pavarur, i krijuar me ligj, struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të nëpunësve të Entit, miratohen me vendim të Kuvendit. Struktura dhe organika e ERRU-së janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 34/2016, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)". Në përbërje të Entit Rregullator të Ujit është Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), Drejtoria Tekniko-Ekonomike, Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit, dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse. Në përbërje të strukturës së ERRU-së janë gjithsej 28 punonjës, nga të cilët 5 anëtarë komisioni, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës. Nga auditimi rezulton se struktura është ngritur sipas miratimit.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

Tabela nr.1, Tabela nr.2, Tabela nr.3 bashkelidhur ne Aneksin III.

Nga auditimi I strukturës organizative, respektimi I saj, funksionimi I sistemit financiar dhe kontrollit të brendshëm nëpërmjet komponentëve të tij, rezultoi se:

-ERRU në strukturë ka 28 punonjës. Nga auditimi mbi plotësimin e organikës së ERRU-së rezultoi se deri në fund të vitit 2018, si dhe deri në fund të vitit 2019 ishte e paplotësuar me 4 punonjës më pak. Për periudhën deri më 30.04.2020, organika është e paplotësuar me 3 punonjës më pak.

Komisioni përcakton rregullat e punësimit të stafit të tij profesionist, si dhe përcakton organizimin e stafit profesionist në përputhje me legjislacionin në fuqi sipas ligjit nr.8102 datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrërave të ndotura”, (i ndryshuar) dhe të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë, (i ndryshuar) si dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Gjithë procedura e përzgjedhjes së kandidatëve menaxhohet në bashkëpunim me Drejtorinë përkatëse që përcaktojnë kriteret e punësimit të cilat miratohen më pas nga KKRR-ja.

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar 7 procedura për plotësimin e vendeve vakante.

Për ndjekjen e procedurave të plotësimit të vendeve të lira të punës në ERRU, është ngarkuar Komisioni i Blerjeve të Vogla i krijuar me urdhrin nr.7, datë 15.01.2019 dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

#### **Procedura 1 :**

Në zbatim të nenit 9 të ligjit nr.8102, datë 28.03.1996 ‘Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrërave të ndotura’, (i ndryshuar), KKRR me anë të Vendimit nr. 81, datë 17.12.2018 punonjësi **Specialist protokoll-arkiv** është emëruar **Specialist i marrëdhënieve me publikun.**

Në vijim të Urdhrit nr.119, datë 26.12.2018 “Për emërim në detyrë” të Kryetarit të KKRR është nënshkruar kontrata individuale më datë 01.01.2019

#### **Procedura 2 :**

Në zbatim të nenit 9 të ligjit nr.8102, datë 28.03.1996 ‘Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrërave të ndotura’, i ndryshuar, KKRR me anë të Vendimit nr.82, datë 17.12.2018 punonjësi **Specialist finance pranë DSHM** është emëruar **Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve mbështetëse.**

Në vijim të Urdhrit nr.120, datë 26.12.2018 “Për emërim në detyrë” të Kryetarit të KKRR është nënshkruar kontrata individuale më datë 01.01.2019.

#### **Procedura 3:**

Me Urdhër të Brendshëm nr.16 prot., datë 06.02.2019 për “*Botimin e njoftimit në shtyp për vend të lirë pune*” të Kryetarit të Autoritetit Kontraktor, janë zhvilluar procedurat për plotësimin e 1 (një) vendi vakant **Specialist protokoll-arkiv.**

Në përfundim të procesit të verifikimit të kandidaturave, KKRR me Vendimin nr.12, datë 06.03.2019 për “Vlerësimin e kandidateve për vendet e lira të punës ka shpallur fituesin për vendin vakant të **Specialist protokoll-arkiv.**

Në vijim të Urdhrit nr. 27 datë 11.03.2019 “Për emërim në detyrë” të Kryetarit të KKRR është nënshkruar kontrata individuale më datë 15.03.2019.

#### **Procedura 4:**

Me Urdhër të Brendshëm nr.34 prot., datë 05.04.2019 për “*Botimin e njoftimit në shtyp për vend të lirë pune*” të Kryetarit të Autoritetit Kontraktor, janë zhvilluar procedurat për plotësimin e 1 (një) vendi vakant **Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.**



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

Në përfundim të procesit të verifikimit të kandidaturave, KKRR me Vendimin nr.25, datë 08.05.2019 për “Vlerësimin e kandidateve për vendet e lira të punës ka shpallur fituesin për vendin vakant të **Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse**.

Në vijim të Urdhrit nr.52, datë 31.05.2019 “Për emërim në detyrë” të Kryetarit të KKRR është nënshkruar kontrata individuale më datë 03.06.2019.

#### **Procedura 5:**

Me Urdhër të Brendshëm nr.36 prot., datë 08.04.2019 për “*Botimin e njoftimit në shtyp për vend të lirë pune*” të Kryetarit të Autoritetit Kontraktor, janë zhvilluar procedurat për plotësimin e 1 (një) vendi vakant **Specialist Finance pranë DSHM**.

Në përfundim të procesit të verifikimit të kandidaturave, KKRR me Vendimin nr.24, datë 08.05.2019 për “Vlerësimin e kandidateve për vendet e lira të punës ka shpallur fituesin për vendin vakant të **Specialist Finance pranë DSHM**.

Në vijim të Urdhrit “Për emërim në detyrë” të Kryetarit të KKRR është nënshkruar kontrata individuale më datë 15.05.2019.

#### **Procedura 6:**

Me Urdhër të Brendshëm nr.48 prot., datë 24.04.2019 për “*Botimin e njoftimit në shtyp për vend të lirë pune*” të Kryetarit të Autoritetit Kontraktor, janë zhvilluar procedurat për plotësimin e 1 (një) vendi vakant **Anëtar i KKRR**.

Në përfundim të procesit, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.382, datë 12.06.2019 është emëruar në detyrë Anëtari i KKRR

Ne vijim me Urdhrit nr.56, datë 17.06.2019 “Për fillimin e marrëdhënieve të punës” të Kryetarit të KKRR kanë filluar efektet financiare nga data 18.06.2019.

#### **Procedura 7:**

Me Urdhër të Brendshëm nr.76 prot., datë 16.09.2019 për “*Botimin e njoftimit në shtyp për vend të lirë pune*” të Kryetarit të Autoritetit Kontraktor, janë zhvilluar procedurat për plotësimin e 1 (një) vendi vakant **Sekretare e KKRR dhe Kryetarit**.

Në përfundim të procesit të verifikimit të kandidaturave, KKRR me Vendimin nr.49, datë 10.10.2019 për “Vlerësimin e kandidateve për vendet e lira të punës” ka shpallur fituesin për vendin vakant të **Sekretare e KKRR dhe Kryetarit**.

Në vijim të Urdhrit nr. 79 datë 10.10.2019 “Për emërim në detyrë” të Kryetarit të KKRR është nënshkruar kontrata individuale më datë 21.10.2019.

Pozicione pune vakante më datë 31.12.2019, janë gjithsej 4 :

Drejtor – Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit	1(një)
Anetar i KKRR	1(një)
Specialist i analizës ekonomiko financiare, sektori ekonomik dhe I tarifave, DTE	1(një)
Specialist i burimeve njerëzore, sektori I burimeve njerëzore dhe financave pranë DSHM	1(një)
Gjatë vitit 2020 deri me 30.04.2020 janë zhvilluar 2 procedura për plotësimin e vendeve vakante	
Për ndjekjen e procedurave të plotësimit të vendeve të lira të punës në ERRU, është ngarkuar Komisioni i Blerjeve të Vogla i krijuar me urdhrin nr.2, datë 13.01.2020 dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	

#### **Procedura 1:**

Me Urdhër të Brendshëm nr.10 prot., datë 16.01.2020 për “*Botimin e njoftimit në shtyp për vend të lirë pune*” të Kryetarit të Autoritetit Kontraktor, janë zhvilluar procedurat për plotësimin e 1 (një) vendi vakant **Anëtar i KKRR**.

Në përfundim të procesit me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.111, datë 13.02.2020 është emëruar në detyrë Anëtari i KKRR.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

Në vijim, me Urdhrin nr.10/1, datë 17.02.2020 “Për fillimin e marrëdhënieve të punës” të Kryetarit të KKRR kane filluar efektet financiare nga data 19.02.2020.

#### Procedura 2:

Me Urdhër të Brendshëm nr.47 prot., datë 10.03.2020 për “Botimin e njoftimit në shtyp për vend të lirë pune” të Kryetarit të Autoritetit Kontraktor, janë zhvilluar procedurat për plotësimin e 3 (tre) vendeve vakante **Kryetar I KKRR, Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Specialist i analizës ekonomiko-financiare.**

Ne vijim të urdhrin nr.156, datë 10.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga covid-19” dhe VKM nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” procedura është pezulluar.

Pozicione pune vakante më datë 30.04.2020, janë gjithsej 3 :

Drejtor – Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit 1(nje)  
Specialist i analizës ekonomiko financiare, sektori ekonomik dhe I tarifave, 1(nje)  
Specialist i burimeve njerëzore, sektori I burimeve njerëzore dhe financave pranë DSHM 1(një)

<b>Titulli i Gjetjes 1:</b>	<i>Plotësimi i organikës</i>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi mbi plotësimin e organikës së ERRU-së zbatim të vendimit nr.34/2016 të Kuvendit “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, rezultoi se për periudhën deri më 30.04.2020, organika është e paplotësuar me 3 punonjës më pak
<b>Kriteri:</b>	<i>Ligji nr.8102 datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrërave të ndotura”, (i ndryshuar) Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë, (i ndryshuar)</i>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos plotësimi i vendeve vakante ndikon në mospërmushjen e objektivave të institucionit
<b>Shkaku:</b>	Mos plotësimi i vendeve vakante
<b>shRëndësia:</b>	I mesëm

#### 2.ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE

Pagat - Të dhënat në tabelat e mëposhtëme pasqyrojnë treguesit e realizimit të fondit të pagave për periudhat raportuese 2018 - 30.04.2020. Në total për vitin 2018 është 90%, për vitin 2019 është 81%, dhe për periudhën 4-mujore të vitit 2020 deri me 30.04.2020 është 73%., Mosrealizimi i fondit të pagave, kryesisht ka ardhur si rezultat i mos plotësimit të strukturës organike. Nga 28 punonjës në strukture numri për periudha të caktuara ka arritur deri në 24-25 punonjës. (periudha 2018, 4 persona më pak se struktura, periudha 2019, 4 persona më pak se struktura, periudha 2020 deri me 30.04.2020, 3 persona më pak se struktura).



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

Nr	Viti 2018 Emertimi	Çelja	Shkresa nr. dt	Shpenzime Operative		Plan	Fakt	%
				+	-			
1	Paga	27,693,000	VKM nr.26 date 17.01.2018	3,180,700	-	30,873,700	27,992,722	94%
	Shtese fondi paga efekt i rritjes pagave (600)	-		-	-	-	-	
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor (601)	4,638,500				4,638,500	4,093,884	88%
<b>Totali</b>		<b>32,331,500</b>	<b>-</b>	<b>3,180,700</b>	<b>-</b>	<b>35,512,200</b>	<b>32,086,606</b>	<b>90%</b>

Nr	Viti 2019 Emertimi	Çelja	Shkresa nr. dt	Shpenzime Operative		Plan	Fakt	%
				+	-			
1	Paga	32,447,000	VKM nr.3 date 09.01.2019 dhe VKM nr.337 date 22.05.2019	1,735,400	-	34,182,400	27,489,553	80%
	Shtese fondi paga efekt i rritjes pagave (600)	-		-	-	-	-	
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor (601)	4,840,000				4,840,000	4,117,563	85%
<b>Totali</b>		<b>37,287,000</b>	<b>-</b>	<b>1,735,400</b>	<b>-</b>	<b>39,022,400</b>	<b>31,607,116</b>	<b>81%</b>

Nr	Viti 30.04.2020 Emertimi	Çelja	Shkresa nr. dt	Shpenzime Operative		Plan	Fakt	%
				+	-			
1	Paga	10,546,148	VKM nr.709 date 06.11.2019	788,400	-	11,334,548	8,365,252	74%
	Shtese fondi paga efekt i rritjes pagave (600)	-		-	-	-	-	
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor (601)	1,868,864				1,868,864	1,315,132	70%
<b>Totali</b>		<b>12,415,012</b>	<b>-</b>	<b>788,400</b>	<b>-</b>	<b>13,203,412</b>	<b>9,680,384</b>	<b>73%</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

*Te dhënat janë disponuar nga Specialisti i Financës*

- Krahasimi përmbledhës së listëpagesave me shumat e urdhër shpenzimit e pagesa e kryer.

U bë krahasimi përmbledhës i listëpagesave me likuidimet, ndërsa nuk u konstatuan pasaktësi në shpenzimet për paga e sigurime. Pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës listë-prezencat, urdhër shpenzimet për paga dhe urdhra të veçantë të titullarit.

-Respektimi i dispozitave ligjore për përcaktimin e nivelit të pagave, hapja dhe azhornimi periodik i regjistrit të punëmarrësve (libri i pagave). Niveli i pagave është përcaktuar në zbatim të:

- Ligjit Nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, Lidhja nr. 1

- VKM 187 datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” Lidhja nr.1

- Ligjit Nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” Lidhja nr. 1

Nga auditimi me përzgjedhje i listëpagesave për periudhat raportuese (3/mujori IV-të 2018; 3/mujori IV-të 2019; 3/mujori I-të 2020,) u verifikua niveli pagave për çdo punonjës, arsimimi sipas diplomës, vjetërsia në punë me librezën e secilit, ndërsa nuk u konstatuan mospërputhje të nivelit të diplomës me kategorinë e vendit të punës dhe funksionit sipas emërimit. Për rrjedhojë rezultoi se ato janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjet dhe VKM e sipër përmendura. Përlllogaritjet e kontributit sigurime shoqërore e shëndetësore përballuar nga punëmarrësi dhe ato nga punëdhënësi, deklaratimet, ndalesat si dhe derdhjet e tyre janë bërë në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 7770, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Listë pagesat janë përpiluar me gjithë elementet përbërës, sipas listë prezencave dhe shumat e tyre janë të rakorduara. Vendosja e pagave e shtesave mbi pagë janë bërë me klasën përkatëse për çdo kategori dhe ndalesat janë përlllogaritur në përputhje me dispozitat ligjore për kontributet e sigurimeve dhe tatimi mbi të ardhurat, sipas pasqyrës së realizimit të buxhetit.

Për përdorimin e fondit të pagave, sigurime shoqërore e shëndetësore është respektuar legjislacionin përkatës ligji nr. 9136, datë 11.09.2013 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 16.04.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” i ndryshuar dhe ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar janë bërë llogaritjet dhe ndalesat për tatimin mbi të ardhurat si dhe derdhjet e tyre në favor të tatimeve. Për periudhën objekt auditimi nuk rezultuan pagesa për orë jashtë kohës normale të punës, ndërsa nuk është kryer asnjë pages

për ndihmë ekonomike dhe nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve në strukturën organizative. Është mbajtur libër për pagat e punonjësve, dhe janë hedhur pagesat e kryera për secilin punonjës për periudhën të përcaktuar nga emërimi, fillimi marrëdhënive të punës dhe të rakorduar me listë pagesat.

Dosjet e personelit

-Për nëpunësit e ERRU-së organizimi përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi Ligjit nr.8102 date 28.03.1996 ‘Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit te ujrërave të ndotura”, i ndryshuar ligji dhe të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar si dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore ne fuqi. Nga auditimi dosjeve rezultoi sedosjet nuk jan inventarizuar e protokolluar në zbatim VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

regjistrin qendror të personelit”, ndërsa për periudhën e audituar për cdo punonjës është kryer vlerësimi periodik i rezultateve individuale në punë të bashkëlidhura në çdo dosje të nëpunësit. Dosjet origjinale të punonjësve administrohen nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

Të gjitha dosjet janë plotësuar në zbatim të **Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014**, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit. Në dosjen teknike të nëpunësit janë përfshirë : **LIDHJA NR 1.** “Fletëinventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje dhe **LIDHJA NR 2.** “Të dhënat që duhet të përmbajë fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit 1. Numri i identifikimit të nëpunësit civil; 2. Emri, atësia, mbiemri; 3. Numri kombëtar i identifikimit; 4. Shtetësia; 5. Gjinia; 6. Datëlindja; 7. Gjendja civile; 8. Përbërja familjare; 9. Adresa e vendbanimit të përhershëm; 10. Adresa e vendbanimit të përkohshëm; 11. Arsimimi; 12. Diploma; 13. Kualifikimi (llojet); 14. Gradë shkencore (titulli); 15. Njohuri gjuhe të huaj; 16. Data e fillimit të punës në pozicionin përkatës;”

Nuk ka tejkallim të strukturës, ndërsa mos plotësimi, numri punonjësve, planifikim e realizim fondi shpenzime kosto personeli paraqiten në tabelat e mëposhtme:

ERRU-Vakancat për vitin 2020			
NR	EMERTESA E POZICIONIT	NIVELI (ekzekutiv )	KATEGORIA E PAGËS
<b>DREJTORIA TEKNIKO- EKONOMIKE</b>			
<i>Spektori Ekonomik dhe i Tarifave</i>			
1	Specialist i analizës ekonomiko-financiare	Ekzekutiv	III-b
<b>DREJTORIA JURIDIKE DHE KONSUMATORIT</b>			
1	Drejtor Drejtorie	I mesem	II-b
<b>DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE</b>			
<i>Spektori Burimeve Njerëzore dhe Financiare</i>			
1	Specialist i burimeve njerëzore	Ekzekutiv	III-b
<b>3</b>	<b>TOTALI</b>		

*Te dhënat janë disponuar nga Specialisti i Financës*

Për periudhën objekt auditimi në institucion u konstatua se deri në date 30.04.2020 numri punonjësve ka qenë 25 punonjës, kundrejt 28 punonjësve të strukturës organizative.

#### Rregullorja

- ERRU është ristrukturuar me VKM 34/2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Entit, si organ i specializuar në kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë pasqyrohen në rregulloren e brendshme “Për Organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Rregullorja e re është miratuar nga KKRR me vendimin me Nr prot. 16 datë 28.04.2017. Kjo rregullore është në përshtatje me kërkesat e paketës së re ligjore të miratuar për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi.

#### Vendimet gjyqësore

- Për periudhën objekt auditimi institucioni nuk kishte asnjë proces gjyqësor për marëdhëniet e punës.

### 3.FINANCIMI DHE ZBATIMI I BUXHETIT TË ERRU

#### Nga auditimi rezultoi se:

**Burimet e financimit të Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotur** : Janë pagesat rregullatore vjetore dhe pagesat e licencimit të vendosura nga Enti Rregullator, të detyrueshme për operatorët dhe donacione të ndryshme. **Komisioni Kombëtar i Rregullimit** është organi kolegjal që udhëheq Entin Rregullator të Ujit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 “ Për kuadrin rregullator të sektorit të





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotur” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore dhe ushtron funksionet me anë të vendimmarrjes në mbledhjet e tij, të cilat organizohen dhe mbahen në përputhje me ligjin nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, si dhe rregullat e përcaktuara në rregulloren e institucionit. Referuar nenit 16 gërma 1 të rregullores Kompetenca e Komisioni Kombëtar të Rregullimit është se : *Miraton Projekt buxhetin e ERRU për vitin e ardhshëm, sipas legjislacionit në fuqi.* Në rregulloren e brendshme të institucionit parashikohet se Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese ka si detyra kryesore: 1. Bashkërendimin e punës për realizimin e procedurave për planifikimin e planeve vjetore buxhetore të ERRU, që garantojnë zhvillimin normal të veprimtarisë, si dhe ndjekjen e zbatimit e buxhetit të miratuar.

2. Ndjekjen, bashkërendimin e veprimeve për garantimin e financimit të veprimtarisë së institucionit përmes pagesave të rregullimit e monitorimit të vazhdueshëm të tyre.

3. Realizimin e veprimtarive financiare të ERRU, monitorimin e shpenzimeve buxhetore, hartimin e pasqyrave financiare vjetore, përgatitjen e informacioneve për raportime periodike mbi të ardhurat dhe shpenzimet. Kontabilizimi i dokumentacionit dhe likuidimi i detyrimeve në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore .

***Në Nenin 40 të rregullores Buxheti përcaktohet se:***

***1. ERRU*** sipas parashikimeve në programin dhe objektivat vjetore të punës të përcaktuara nga KKRR për vitin pasardhës, harton projekt-buxhetin vjetor, në formën e një fondi shpenzimesh administrative dhe investimesh për nevojat e tij, jo më vonë se tre muaj para mbylljes së vitit paraardhës.

2. Jo më vonëse 6 (gjashtë) mujori i parë i vitit KKRR miraton programin dhe objektivat vjetore të punës për vitin pasardhës. KKRR jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit nga Këshilli i Ministrave të planit të shpenzimeve vjetore, miraton detajimin e planit të shpenzimeve.

3. Projekt buxheti hartohet dhe paraqitet përpara KKRR nga Grupi Strategjik i Menaxhimit.

Për sa sipërcituar:

***Miratimi i fondit vjetor të shpenzimeve operative të ERRU, është në kompetencën e Këshillit të Ministrave , pavarësisht se këto fonde , nuk financohen nga buxheti i shtetit por sigurohen tërësisht nga të ardhurat që krijon Enti nga veprimtaria e tij.*** Në zbatim të pikës 1 të nenit 11, të ligjit 8102, datë 28.03.1996 “ Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura”, në muajin shtator të çdo viti, ERRU ka paraqitur pranë Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, fondin vjetor të shpenzimeve operative për vitin pasardhës.

***Në zbatim të nenit 10 Financimi i Entit Rregullator***

1. Operacionet e Entit Rregullator financohen nga:

a) burimet e financimit të Entit Rregullator që përbëhen nga pagesat e rregullimit, të vendosura nga ajo vetë për operatorët, që operojnë në sistemet e furnizimit me ujë, të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe trajtimit të tyre, nga pagesat e licencave dhe nga donacione të ndryshme;

2. Fondet e Entit Rregullator administrohen nëpërmjet llogarive të hapura në banka shqiptare të miratuara nga Këshilli i Ministrave i Shqipërisë .

***Burimet e financimit të ERRU, përcaktohen në nenin 11 të ligjit 8102, datë 28.03.1996 “ Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura” ku përcaktohet se Buxheti dhe llogaritë financiare të Entit Rregullator:***

1. Jo më vonë se tre (3) muaj para fillimit të çdo viti fiskal, Enti Rregullator do të ndërtojë një fond të shpenzimeve të parashikuara operative për t’ia paraqitur për miratim Këshillit të Ministrave.
2. Enti Rregullator do të mbajë llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.
3. Të gjitha të ardhurat e tepërta mbi shpenzimet e Entit Rregullator do të kalohen në buxhetin e shtetit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së propozohet nga ajo vetë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura".

Për periudhën objekt auditimi rezultoi se në përgjithsi janë respektuar dispozitat ligjore të parashikuara në nenin 10 dhe neni 11 të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotur".

Ligji nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

Nga auditimi i kryer për planifikimin e buxhetit për vitin 2018 në raport me realizimin e tij u konstatuan se sipas artikujve buxhetor zëri Shpenzime operative, art. (602) është realizuar në vlerën 6,847,658 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 10,016,500 lekë ose 68 %. Referuar të dhënave të sipër cituara, zëri Shpenzime operative, art. (602) për vitin 2018, paraqitet me mos realizim. Për planifikimin e buxhetit për vitin 2019 në raport me realizimin e tij u konstatuan se realizimi i shpenzimeve korrente sipas programit buxhetor për vitin 2019 paraqitet me mosrealizim konkretisht : të realizuara në vlerën 631,200 lekë, kundrejt planifikimit në vlerën 1,080,000 lekë ose 58%.

#### Viti 2018

Me shkresën nr.265 prot, datë 28.09.2017 në zbatim të pikës 1 të nenit 11, të ligjit 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i është dërguar Ministrisë së Financave projekt vendimi "Për miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2018, për ERRU si dhe relacioni përkatës". Me shkresën nr.265 prot, datë 28.09.2017 në zbatim të pikës 1 të nenit 11, të ligjit 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i është dërguar Këshillit të Ministrave projekt vendimi "Për miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2019, për ERRU si dhe relacioni përkatës. Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së, për vitin 2018 është miratuar me VKM nr. 26, datë 17.01.2018, "Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2018, të Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotur". Detajimi i planit të shpenzimeve operative në përputhje me kuotat e miratuar nga Këshilli i Ministrave është në kompetencë të Komisionit Kombëtar Rregullator, ndaj në muajin janar, me Vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr.23, datë 24.01.2018 janë detajuar kuotat e shpenzimeve sipas artikujve , në përputhje me nevojat e institucionit. Në planin vjetor të Entit, shpenzimet për personelin (paga + sigurime shoqërore) përbëjnë 65% të totalit të planit vjetor të shpenzimeve dhe 35% janë shërbime e furniturë dhe investime. Në total plani i miratuar është në shumën 49,648,000 lekë dhe i detajuar në katër zërat kryesorë: paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, shërbime e furniturë dhe investime. Shpenzimet e kryera të detajuara dhe në përqindje të realizimit paraqiten si më poshtë:

- ✓ 26,038 mijë lekë, shpenzime për pagat e punonjësve. (94%)
- ✓ 4,104 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore. (88%)
- ✓ 6,845 mijë lekë, shpenzime për shërbime e furniturë. (68%)
- ✓ 7,176 mijë lekë, shpenzime për investime. (98%)

Shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të veprimtarisë vjetore të Entit gjatë vitit 2018, janë në shumën 44,162,369 lekë, ose 89 % të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative. Arsyeja kryesore e uljes së shpenzimeve në krahasim me ato të planifikuara është se fondi i planifikuar në zërin "shërbime e furniturë" është realizuar në masën 68% kryesisht nga ulja e zërave shpenzime në energji elektrike, shpenzime për aktivitete dhe mirëmbajtje mjete transporti.

Sipas programit Menaxhim Administrim, për vitin 2018, shumat e alokuara në fillim të vitit buxhetor, dhe realizimi paraqitet sipas tabelës me të dhënat:

në 000/lekë

Emertimi	Buxheti fillestar	Ndryshimet	Buxheti	Realizimi	%
----------	-------------------	------------	---------	-----------	---



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

	a	2018		f		
		b	c		d	e
			AN	2018 (I ndryshuar)	FAKT	
1	Paga Artikulli 600	27.693.000	-	27.693.000	26.041.422	94%
2	Sigurimet shoqërore Artikulli 601	4.638.500	-	4.638.500	4.093.884	88%
3	Artikulli 602	10.016.500	-	10.016.500	6.847.658	68%
4	Investime 231	7.300.000	-	7.300.000	7.176.000	98%
	<b>Totali</b>	<b>49.648.000</b>		<b>49.648.000</b>	<b>44.158.964</b>	<b>89%</b>

*Burimi informacionit :Sektori i Financës*

Referuar të dhënave të sipër cituara, zërat buxhetor për vitin 2018, nuk kanë pësuar ndryshime krahasuar me ato të planifikuara në fillim të vitit, për rrjedhojë realizimi i artikujve buxhetorë në përqindje paraqitet:

- Artikulli paga (600) është 94 % ose – 1,651,578 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 27,693,000 lekë;
- Sigurimet shoqërore art. (601) është realizuar 88% ose – 544,616 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 4.638.500 lekë;
- Shpenzime operative, art. (602) është 68 % ose – 3,168,842 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 10,016,500 lekë.
- Investimet rezultojnë të realizuara në vlerën 7,176,000 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 7,300,000 lekë ose 98% ose – 124,000 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 7,300,000.

*Realizimi i buxhetit, sipas artikujve buxhetorë viti 2018, paraqitet sipas tabelës me të dhënat:  
në 000/lekë*

Nr.	EMERTIMI	VITI 2018		
		PLAN	FAKT	Në %
1	Paga, art. (600)	27,693,000	26,041,422	94%
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	4,638,500	4,093,884	88%
3	Shpenzime operative, art. (602)	10,016,500	6,847,658	68%
4	Transferta korente te brendshme (604)			
5	Shpenzime transfera me jashte, art. (605)			
6	Transf.per buxhete familjare&individivee (606)			
	<b>Nen-Totali Shpenzime Korrente</b>	<b>42,348,000</b>	<b>36,982,964</b>	<b>87%</b>
1	Investime, art. (230)			
2	Investime , art. (231)			
	Investime per Mjete Transporti	7.300.000	7.176.000	98%
	<b>Nen-Totali Shpenzime Kapitale</b>	<b>7,300,000</b>	<b>7,176,000</b>	<b>98%</b>
	<b>BUXHETI</b>	<b>49,648,000</b>	<b>44,158,964</b>	<b>89%</b>

*Burimi informacionit :Sektori i Financës*

Referuar të dhënave të sipër cituara, artikujt buxhetor për vitin 2018, paraqiten me mos realizim. Artikulli paga (600) është realizuar në vlerën 26,041,422 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 27,693,000 lekë ose 94 %,

Sigurimet shoqërore art. (601) është realizuar në vlerën 4,093,884 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 4,638,500 lekë ose 88%, Shpenzime operative, art. (602) është realizuar në vlerën 6,847,658 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 10,016,500 lekë ose 68 %. Nën totali shpenzime korrente rezulton i realizuar në vlerën 36,982,964 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 42,348,000 lekë ose 87 %. Shpenzimet kapitale rezultojnë të realizuara në vlerën 7,176,000 lekë, kundrejt planifikimit në vlerën 7,300,000 lekë ose 98%. Në total buxheti është realizuar në vlerën 44,158,964 lekë, kundrejt planifikimit në vlerën 49,648,000 lekë (-5,489,036 lekë) ose 89 %.

*Realizimi i shpenzimeve korrente sipas programit buxhetor për vitin 2018 paraqitet sipas tabelës:  
në 000/lekë*

Nr.	602	Objekti i prokurimit	Planifikuar	Realizuar	Ne %
			2018	2018	
	6020	<b>Materiale zyre e te pergjithsh</b>	<b>429.500</b>	<b>404.890</b>	<b>94%</b>
1	602001	kancelari	105.000	105.310	100%
2	602002	materiale pastrimi	120.000	117.060	98%
3	602003	materiale printimi	120.500	113.520	94%
5	602004	materiale e miremb. e ambienteve te punes	84.000	69.000	82%
	6022	<b>sherbime nga te trete</b>	<b>1.268.300</b>	<b>653.818</b>	<b>52%</b>
6	602202	njoftime ne shtyp	100.000	31.400	31%



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

7	602203	komisione bankare	90.000	61.400	68%
8	602204	sherbim postar	150.000	59.212	39%
9	602205	shp.interneti + website	300.000	251.290	84%
10	602206	shpenzime per energji elektrike	301.000	6.206	2%
11	602207	shpenzime per uje	90.000	56.170	62%
12	602208	telefon fiks	37.000	23.478	63%
13	602209	telefon mobile	200.300	164.662	82%
	<b>6023</b>	<b>sherbime transporti</b>	<b>976.000</b>	<b>899.160</b>	<b>92%</b>
14	602301	karburante	315.000	295.868	94%
15	602302	parkim dhe larje e autoveturave	136.000	89.200	66%
16	602303	sig. dhe taksa te mjeteve te transportit	285.000	274.092	96%
17	602304	bonus transporti	240.000	240.000	100%
	<b>6024</b>	<b>shpenzime udhetimi</b>	<b>2.950.000</b>	<b>2.667.599</b>	<b>90%</b>
18	602401	udhetim e dieta jashte vendit	2.450.000	2.210.099	90%
19	602402	udhetim e dieta brenda vendit	500.000	457.500	92%
	<b>6025</b>	<b>shpenzime per miremb te zakonshme</b>	<b>292.500</b>	<b>63.980</b>	<b>22%</b>
20	602501	mirembajtje mjete transporti	95.000	15.980	17%
21	602502	mirembajtje pajisje	197.500	48.000	24%
	<b>6029</b>	<b>shpenzime te tjera operative</b>	<b>4.100.200</b>	<b>2.158.211</b>	<b>53%</b>
22	602901	kuotacion per aderim ne org.nderkomb	50.000	41.565	83%
23	602902	shpenzime per pritje percjellje	120.000	46.960	39%
24	602903	taksa vendore dhe shpenzime gjyqesore	194.000	74.376	38%
25	602905	abonime ne shtyp	35.500	29.430	83%
26	602906	botime	120.000	118.800	99%
27	602907	pagese auditimi	120.000	102.000	85%
28	602909	shpenzime per aktivite dhe çorkshop	520.000	33.780	6%
29	602910	shpenzime pagesa ne natyre	2.940.700	1.711.300	58%
		<b>TOTALI</b>	<b>10,016,500</b>	<b>6.847,658</b>	<b>68%</b>

Burimi informacionit :Sektori i Financës

Referuar të dhënave të detajuara për artikullin 602,shpenzimet operative janë realizuar në vlerën 6.847,658 kundrejt planifikimit me vlerë 10,016,500 lekë ose 68%.

Konstatohet se zera të vecantë të artikullit 602, janë me mosrealizim të theksuar kundrejt planifikimit, si sherbime nga te trete është realizuar në vlerën 653.818 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 653.818 lekë ose 52%. Zëri shpenzime per mirembajtje te zakonshme është realizuar në vlerën 63.980 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 292.500 lekë ose 22% Zëri shpenzime te tjera operative është realizuar në vlerën 2.158.211 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 4.100.200 lekë ose 53%.

#### **Detajimi i derdhjes në buxhet për vitin 2018 paraqitet sipas tabelës:**

Për vitin 2018 të ardhurat e tepërta mbi shpenzimet e Entit Rregullator sipas nenit 11 pika 3 e ligjit janë kaluar në buxhetin e shtetit në vlerën 40.658.140,00 lekë. Me urdhrin nr.23 datë 18.02.2019 në mbështetje të nenit 7, pika 3 e nenit 11 të ligjit 8102, datë 28.03.1996 “ Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura”,VKM nr.3,datë 09.01.2019 “ Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2019”, titullari institucionit ka urdhëruar për derdhjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit vlera 40.658.140,00 lekë, si të ardhura të tepërta mbi shpenzimet e miratuara të Entit Rregullator për vitin 2019, si diferencë e gjendjes së likuiditeteve në llogarinë bankare të ERRU me 31.12.2018 me planin e shpenzimeve operative të miratuar për vitin 2019. Data e derdhjes në buxhet dt 18.02.2019.

#### **Viti 2019**

Me shkresën nr.425 prot, datë 28.09.2018 në zbatim të pikës 1 të nenit 11, të ligjit 8102, datë 28.03.1996 “ Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura”, i është dërguar Ministrisë së Financave projekt vendimi “ Për miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2019,për ERRU si dhe relacioni përkatës”. Me shkresën nr.425 prot, datë 28.09.2018 në zbatim të pikës 1 të nenit 11, të ligjit 8102, datë 28.03.1996 “ Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura”,është dërguar Këshillit të Ministrave projekt vendimi “ Për miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2019,për ERRU si dhe relacioni përkatës”. Plani i shpenzimeve operative vjetore të ERRU për vitin 2019, është miratuar me VKM nr.3 datë 09.01.2019 “ Për miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2019, të ERRU ” në total në shumën 45 394 000 lekë i ndryshuar me vendimin nr.337 datë 22.05.2019 “ Për disa ndryshime në vendimin



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

nr.3, datë 09.01.2019, të KM, "Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2019, të ERRU", duke përcaktuar se: Miratimi i planit të shpenzimeve për vitin 2019, të ERRU të jetë në shumën 50 249 000 lekë. Detajimi i planit të shpenzimeve operative, është në kompetencë të KKRR, në përputhje me kuotat e miratuara nga KM, ndaj në muajin janar është detajuar me Vendimin nr.2, datë 15.01.2019 kuotat e shpenzimeve sipas artikujve, në përputhje me nevojat e institucionit. Me kërkesë të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse për ndryshimin në vlera të disa zërave brenda klasave, KKRR ka miratuar ndryshimet me vendimin nr.40 datë 17.07.2019 dhe vendimin nr.50 datë 28.10.2019.

Shumat e alokuara në fillim të vitit për programin buxhetor 2019, me ndryshimet përkatëse dhe realizimi paraqitet sipas tabelës:

në 000/lekë

	Emrtimi	Buxheti fillestar 2019	Ndryshimet		Realizimi FAKT	%
			AN	Buxheti 2019 (I ndryshuar)		
	a	b	c	d	e	f
1	Paga Artikulli 600	28,035,000	4,412,000	32,447,000	25.754.353	79%
2	Sig. shoq Artikulli 601	4.397.000	443.000	4.840.000	4.117.563	85%
3	Artikulli 602	11.882.000	-	11.882.000	9.547.313	80%
4	Investime 231	1.080.000	-	1.080.000	717.600	66%
	<b>Totali</b>	<b>45,394,000</b>	<b>4,855,000</b>	<b>50,249,000</b>	<b>40,136,828</b>	<b>80%</b>

Burimi informacionit :Sektori i Financës

Për vitin 2019, me aktet ligjore e nënligjore, buxheti fillestar i alokuar në vlerën 45,394,000 lekë, në fillim të vitit, për ERRU është ndryshuar duke u shtuar gjithsej me vlerën +4,855,000 lekë. Plani i buxhetit përfundimtar i ERU për vitin 2019 është 50,249,000 lekë, ku rezulton i realizuar në vlerën 40,136,828 lekë ose 80% e fondeve të alokuara.

Ndryshimet të vlerës fillestare janë bërë në të gjitha zërat: Fondi i pagave është shtuar me vlerën +4,412,000 lekë, Sigurimet shoqërore janë shtuar me vlerën 443.000 lekë, Shpenzime operative dhe investimet (231) nuk kanë pësuar ndryshime duke ruajtur vlerën e planifikuar në buxhetin fillestar..

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se në asnjë prej zërave nuk ka tejkalim në realizimin faktik të buxhetit kundrejt planifikimit vjetor.

Realizimi i buxhetit, sipas artikujve buxhetorë për vitin 2019 paraqitet sipas tabelës:

në 000/lekë

Nr.	EMERTIMI	VITI 2019		
		PLAN	FAKT	Në %
1	Paga, art. (600)	32,447,000	25,754,353	79%
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	4,840,000	4,117,563	85%
3	Shpenzime operative, art. (602)	11,882,000	9,547,313	80%
4	Transferta korente te brendshme (604)			
5	Shpenzime transferata me jashte, art. (605)			
6	Transf.per buxhete familjare&individee (606)			
	<b>Nen-Totali Shpenzime Korrente</b>	<b>49,169,000</b>	<b>39,419,228</b>	<b>80%</b>
1	Investime, art. (230)			
	<b>23003</b> Invest. per Koncesione, Patenta, Licenca etj (Prog. F5)	120.000	120.000	100%
2	Investime , art. (231)			
	<b>231014</b> Invest per Instalime teknik, mak. dhe pajisje (Lap Top+Licenca)	240.000	120.000	50%
	<b>231018</b> Investime per Inventari ekonomik (Mobilje dhe pajisje Zyre)	720.000	391.200	54%
	<b>Nen-Totali Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,080,000</b>	<b>631,200</b>	<b>58%</b>
	<b>BUXHETI</b>	<b>50,249,000</b>	<b>40,050,428</b>	<b>80%</b>

Burimi informacionit :Sektori i Financës

Referuar të dhënave të sipër cituara, artikujt buxhetor për vitin 2019, paraqiten me mos realizim. Artikulli paga (600) është realizuar në vlerën 25,754,353 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 32,447,000 lekë ose 79 %, Sigurimet shoqërore art. (601) është realizuar në vlerën 4,117,563 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 4,840,000 lekë ose 85%, Shpenzime operative, art. (602) është realizuar në vlerën 9,547,313 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 11,882,000 lekë ose 80 %. Nën totali shpenzime korrente rezulton i realizuar në vlerën 39,419,228 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 49,169,000



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

lekë ose 80 %. Shpenzimet kapitale rezultojnë të realizuara në vlerën **631,200** lekë, kundrejt planifikimit në vlerën **1,080,000** lekë ose 58%. Në total buxheti është realizuar në vlerën **40,050,428** lekë, kundrejt planifikimit në vlerën **50,249,000** lekë (-10,198,572 lekë) ose 80 %.

Realizimi i shpenzimeve korrente sipas programit buxhetor për vitin 2019 paraqitet sipas tabelës:  
në 000/lekë

Nr	602	Objekti i prokurimit	Planifikuar 2019	Realizuar 2019	Ne %
	<b>6020</b>	<b>materiale zyre e te pergjithshme</b>	<b>558.211</b>	<b>358.236</b>	<b>64%</b>
1	602001	kancelari	120.000	119.133	99%
2	602002	materiale pastrimi	120.000	79.392	66%
3	602003	materiale printimi	120.000	41.500	35%
5	602004	materiale e mirembajtje e ambienteve te punes	198.211	118.211	60%
	<b>6022</b>	<b>sherbime nga te trete</b>	<b>2.743.289</b>	<b>2.216.062</b>	<b>81%</b>
6	602201	sherbim me roje private	1.731.000	1.679.033	97%
7	602202	njoftime ne shtyp	30.000	29.000	97%
8	602203	komisione bankare	153.500	132.346	86%
9	602204	sherbim postar	100.000	46.465	46%
10	602205	shp.interneti + eëbsite	187.789	101.001	54%
11	602206	shpenzime per energji elektrike	173.000	680	0%
12	602207	shpenzime per uje	98.000	54.000	55%
13	602208	telefon fiks	37.000	22.866	62%
14	602209	telefon mobile	233.000	150.671	65%
	<b>6023</b>	<b>sherbime transporti</b>	<b>984.000</b>	<b>759.469</b>	<b>77%</b>
15	602301	karburante	328.000	222.558	68%
16	602302	parkim dhe larje e autoveturave	131.000	96.000	73%
17	602303	sig. dhe taksa te mjeteve te transportit	285.000	200.911	70%
18	602304	bonus transporti	240.000	240.000	100%
	<b>6024</b>	<b>shpenzime udhetimi</b>	<b>3.500.600</b>	<b>3.273.025</b>	<b>93%</b>
19	602401	udhetim e dieta jashte vendit	2.850.600	2.807.025	98%
20	602402	udhetim e dieta brenda vendit	650.000	466.000	72%
	<b>6025</b>	<b>shpenzime per mirembajtje te zakonshme</b>	<b>404.900</b>	<b>189.456</b>	<b>47%</b>
21	602501	mirembajtje mjete transporti	258.000	94.556	37%
22	602502	mirembajtje pajisje	146.900	94.900	65%
	<b>6027</b>	<b>shpenzime per detyrime dhe kompens legale</b>	<b>584.600</b>	<b>584.600</b>	<b>100%</b>
23	602701	shpenzime per detyrime dhe kompensime legale	584.600	584.600	100%
	<b>6029</b>	<b>shpenzime te tjera operative</b>	<b>3.106.400</b>	<b>2.166.495</b>	<b>70%</b>
24	602901	kuotacion per aderim ne org.nderkombetare	320.000	38.340	12%
25	602902	shpenzime per pritje percjellje	120.000	44.800	37%
26	602903	taksa vendore dhe shpenzime gjyqesore	250.000	174.919	70%
27	602904	shpenzime trajnimi	240.000	211.396	88%
28	602905	abonime ne shtyp	45.000	0	0%
29	602906	botime	516.000	99.840	19%
30	602907	pagese auditimi	120.000	102.000	85%
31	602910	shpenzime pagesa ne natyre	1.495.400	1.495.200	100%
		<b>TOTALI</b>	<b>11,882,000</b>	<b>9,547,313</b>	<b>80%</b>

Burimi informacionit :Sektori i Financës

Referuar të dhënave të detajuara për shpenzime operative, art. (602) është realizuar në vlerën 9,547,313 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 11,882,000 lekë ose 80 %.

Konstatohet se zera të vecantë të artikullit 602, janë me mosrealizim të theksuar kundrejt planifikimit, si materiale zyre e të përgjithshme është realizuar në vlerën 358.236 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 558.211 lekë ose 64%.

Zëri shpenzime per mirembajtje te zakonshme është realizuar në vlerën 189.456 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 404.900 lekë ose 47% Zëri shpenzime te tjera operative është realizuar në vlerën 2.166.495 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 3.106.400 lekë ose 70%

#### Detajimi i derdhjes në buxhet për vitin 2019

Për vitin 2019 të ardhurat e tepërta mbi shpenzimet e Entit Rregullator sipas nenit 11 pika



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

3 e ligjit janë kaluar në buxhetin e shtetit në vlerën 1.562.332,00 *lekë*. Me urdhrin nr.48 datë 11.03.2020 në mbështetje të nenit 7, pika 3 e nenit 11 të ligjit 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura” dhe VKM nr.709, datë 06.11.2019 “Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2020”, titullari institucionit ka urdhëruar për derdhjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit vlera 1.562.332,00 *lekë*, si të ardhura të tepërta mbi shpenzimet e miratuara të Entit Rregullator të përlogaritur si diferencë e gjendjes së likuiditeteve në llogarinë bankare të ERRU me 31.12.2019 me detyrimet e prapambetura të ERRU-së ndaj të tretëve pjesë e planit të shpenzimeve operative të miratuar të Entit rregullator për vitin 2020. Data e derdhjes në buxhet dt 12.03.2020.

### 4 mujori i Vitit 2020

Me shkresën nr.366 prot, datë 27.09.2019 në zbatim të pikës 1 të nenit 11, të ligjit 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura”, i është dërguar Ministrisë së Financave projekt vendimi “Për miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2019, për ERRU si dhe relacioni përkatës”. Plani i shpenzimeve operative vjetore të ERRU për vitin 2020, është miratuar me VKM nr.709 datë 06.11.2019 “Për miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2020, të ERRU ” në total në shumën 49 287 733 *lekë*. Sipas programit Menaxhim Administrim, 4 mujori viti 2020, shumat e alokuara në fillim të vitit buxhetor, dhe realizimi paraqitet sipas tabelës:

në 000/lekë

Emërtimi	Buxheti fillestar 2020	Ndryshimet		Buxheti 2020 (I ndryshuar)	Realizimi	
		AN			FAKT deri me 30/04/2020	%
a	b	c		d	e	f
1 Paga Artikulli 600	31.638.443	0		31.638.443	7.959.752	25%
2 Sig. shoq. Artikulli 601	5.606.592	0		5.606.592	1.315.132	23%
3 Artikulli 602	11.910.698	0		11.910.698	1.885.849	16%
4 Investime 231	132.000	0		132.000		0%
<b>Totali</b>	<b>49.287.733</b>			<b>49.287.733</b>	<b>11.160.733</b>	<b>23%</b>

Burimi informacionit :Sektori i Financës

Për vitin 2020, me aktet ligjore e nënligjore, buxheti fillestar i alokuar në vlerën 49,287,733 *lekë*, në fillim të vitit. Plani i buxhetit i ERU deri 30 prill 2020 rezulton i realizuar në vlerën 11,160,733 *lekë* ose 23% e fondeve të alokuara.

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se deri 30 prill 2020 në asnjë prej zëravë nuk ka tejkalim në realizimin faktik të buxhetit kundrejt planifikimit vjetor.

Realizimi i buxhetit, sipas artikujve buxhetorë deri 30 prill 20120 paraqitet sipas tabelës me të dhënat:

në 000/lekë

Nr.	EMERTIMI	VITI 2020		
		PLAN	FAKT	Në %
1	Paga, art. (600)	31.638.443	7.959.752	25%
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	5.606.592	1.315.132	23%
3	Shpenzime operative, art. (602)	11.910.698	1.885.849	16%
4	Transferta korente te brendshme (604)			
5	Shpenzime transferta me jashte, art. (605)			
6	Transf.per buxhete familjare&individee (606)			
	<b>Nen-Totali Shpenzime Korrente</b>	<b>49.155.733</b>	<b>11.160.733</b>	<b>23%</b>
1	Investime, art. (230)			
2	Investime , art. (231)			
231018	Investime per Inventari ekonomik (Mobilje dhe pajisje Zyre)	132.000	-	0
	<b>Nen-Totali Shpenzime Kapitale</b>	<b>132.000</b>	<b>-</b>	<b>0</b>
	<b>BUXHETI</b>	<b>49.287.733</b>	<b>11.160.733</b>	<b>23%</b>

Burimi informacionit :Sektori i Financës



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

Referuar të dhënave të sipër cituara, artikujt buxhetor për vitin 2020 deri më 30 prill 2020, paraqiten :

Artikulli paga (600) është realizuar në vlerën 7,959.752 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 31,638.443 lekë ose 25 %,

Sigurimet shoqërore art. (601) është realizuar në vlerën 1,315.132 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 5,606.592lekë ose 23% , Shpenzime operative, art. (602) është realizuar në vlerën 1.885.849 lekë kundrejt planifikimit në vlerën 11,910.698 lekë ose 16%. Nën totali shpenzime korrente rezulton i realizuar në vlerën **11,160.733** lekë kundrejt planifikimit me vlerë **49,287.733** lekë ose 23 %. Shpenzimet kapitale rezultojnë të parealizuara, kundrejt planifikimit në vlerën **132,000** lekë . Në total buxheti është realizuar në vlerën **11,160.733** lekë, kundrejt planifikimit në vlerën 49,287.733lekë ose 23 %.

Realizimi i shpenzimeve korrente sipas programit buxhetor deri 30 prill 2020 paraqitet sipas tabelës:

në 000/lekë

Nr.	602	Objekti i prokurimit	Planifikuar 2020	Realizuar 2020	Në %
	<b>6020</b>	<b>Materiale zyre e te pergjithshme</b>	<b>480.260</b>	<b>105.360</b>	<b>22%</b>
1	602001	kancelari	179.000		0%
2	602002	materiale pastrimi	105.360	105.360	100%
3	602003	materiale printimi	115.900		0%
5	602004	materiale mirëmbajtje paisjeve te punes	80.000		0%
	<b>6022</b>	<b>sherbime nga te trete</b>	<b>2.662.738</b>	<b>661.397</b>	<b>25%</b>
6	602201	sherbim me roje private	1.895.351	535.641	28%
7	602202	njoftime ne shtyp	98.940	48.000	49%
8	602203	komistone bankare	126.000	17.460	14%
9	602204	sherbim postar	100.000	6.830	7%
10	602205	shp.interneti + eëbsite	114.000		0%
12	602207	shpenzime per uje	64.800		0%
13	602208	telefon fiks	37.200	5.760	15%
14	602209	telefon mobile	226.447	47.706	21%
	<b>6023</b>	<b>sherbime transporti</b>	<b>1.166.000</b>	<b>289.000</b>	<b>25%</b>
15	602301	karburante	510.000		0%
16	602302	parkim dhe larje e autovet	131.000		0%
17	602303	sig. e taksa te mjet te transp.	285.000	209.000	73%
18	602304	bonus transporti	240.000	80.000	33%
	<b>6024</b>	<b>shpenzime udhetimi</b>	<b>3.500.000</b>	<b>324.111</b>	<b>9%</b>
19	602401	udhetim e dieta jashte vendit	3.000.000	272.111	9%
20	602402	udhetim e dieta brenda vend	500.000	52.000	10%
	<b>6025</b>	<b>shpenzime per miremb. te zakonshme</b>	<b>455.500</b>	<b>119.707</b>	<b>26%</b>
21	602501	mirembajtje mjete transporti	258.000		0%
22	602502	mirembajtje pajisje	197.500	119.707	61%
	<b>6029</b>	<b>shpenzime te tjera operative</b>	<b>3.646.200</b>	<b>386.274</b>	<b>11%</b>
24	602901	kuotacion per aderim ne org.nderkombetare	370.000		0%
25	602902	shpenzime per pritje percjellje	240.000		0%
26	602903	taksa vendore dhe shpenzime gjyqesore	220.000	15.000	7%
27	602904	shpenzime trajnimi	240.000		0%
28	602905	abonime ne shtyp	45.000	9.774	22%
29	602906	botime	286.000	36.000	13%
30	602907	pagese auditimi	120.000		0%
31	602910	shpenzime pagesa ne natyre	2.125.200	325.500	15%
		<b>TOTALI</b>	<b>11.910.698</b>	<b>1.885.849</b>	<b>16%</b>

Burimi informacionit : Sektori i Financës

Referuar të dhënave të detajuara për shpenzime operative, art. (602) në total është realizuar në vlerën 1.885.849 lekë kundrejt planifikimit me vlerë 11.910.698 ose 16 %.

#### 4. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE E MONETARE

Në zbatim të pikës nr. 4 të programit të auditimit 393/1, datë 30.04.2020 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër-pagesat.
- Transaksionet e llogarive bankare





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

- Pagesa për shërbime e mallra/shërbime, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme:

**- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës dhe arkës**

- Nga auditimi me zgjedhje mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësismit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit ( fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër shpenzim, etj.) i kryer në Enti Rregullator i Ujit, për veprimet e arkës në valutë dhe veprimet nëpërmjet sistemit bankar rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar

Transaksionet janë kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe gjendja e llogarive bankare rakordon me ekstraktet e bankës në fund të çdo muaji, kjo për sa i përket veprimeve të kryera për periudhën 01.01.2018-31.03.2020..

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-pagesat janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.)

- Të gjitha Urdhër Pagesat e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.09.2018-31.12.2018 janë në vlerën totale 57,082,730 lekë.

- Të gjitha Urdhër Pagesat e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin 2019 janë në vlerën totale 83,395,336 lekë.

- Të gjitha Urdhër Pagesat e kontabilizuara në ditarin e bankës për 4 mujorin e parë të vitit 2020 janë në vlerën totale 11,005,192 lekë.

Urdhër Pagesat e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

*Nga auditimi rezultoi:*

- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj*

- Për vitin 2018 institucioni nuk kishte ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, ndërsa për vitin 2019 deri 31.03.2020 marrja në dorëzim e shërbimeve sipas kontratave të lidhura për mallra/shërbime rast pa rasti janë të konfirmuara dhe dokumentuara rregullisht nga një komision i ngritur nga Titullari i ERRU, në përputhje me përcaktimet e dispozitave dhe kuadrit nënligjor mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm dhe kontabilitetit.

**b. Saktësia dhe rregullueshmëria e veprimeve të kryera në magazinë**

*Ditari i magazinës* është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.

- U audituan me të zgjedhur dokumentacioni i magazinës për periudhën 01.01.2018-31.03.2020 Fletë daljet dhe fletë hyrjet e mallrave janë të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime të plotësuara mr adresën nga vjen mallidhe kujt i dërgohet malli.

Hyrja e mallrave në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletë-hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletë-hyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar. Kontabilizimet e fletë-daljeve dhe fletë hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

Fletë-hyrja e plotësuar nga magazina për hyrjen e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësi, ka të bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë daljen e mallit; Shkresën e Njësisë për transferimin e aktiveve;

#### ***c. Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël***

Nga auditimi u konstatua se ERRU ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", neni 26 ku citohet: "Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ..." dhe neni 31, citohet " ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m<sup>2</sup>, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës... neni 7 (Inventari i aktiveve dhe detyrimeve) të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet.

Komisioni i ngritur me urdhër të titullarit të institucionit nr. 111, datë 06.12.2018 "Për inventarizimin fizik dhe vlerësimin e aktiveve e materiale për vitin 2018" dhe urdhërin nr 105 datë 16.12.2019 "Për inventarizimin fizik dhe vlerësimin e aktiveve e materiale për vitin 2019", para fillimit të inventarit, nuk kishte fiksuar numri rendor të fletë hyrjes dhe fletë daljeve, nëpërmjet procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit., veprim në kundërshtim me pikën 83 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"

Në fund të procesit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve komisioni kishte përpiluar një raport në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve duke dhënë komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve (nëse janë apo jo në përdorim), si dhe për kushtet e ruajtjes së tyre dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, i është dorëzuar për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit, në përputhje me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

Komisioni i inventarizimit fizik dhe vlerësimit të aktiveve pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve ka argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre. Relacioni i bërë nga komisioni përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

#### ***Respektimi i rregullave kontabël për nxjerrjen jashtë përdorimi të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabël për shkarkimin nga magazina***

Komisioni i ngritur me urdhër të titullarit të institucionit nr. 115, datë 06.12.2018 ka bërë nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuar nga komisioni i vlerësimit si jashtë përdorimit, duke mbajtur procesverbalin e shkatërrimit të tyre në përputhje me pikën 109 të

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

#### **5. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR PAJISJEN ME LICENSA TË PERSONAVE FIZIK E JURIDIK DHE PËRCAKTIMI I TARIFAVE TË LICENSIMIT**

Gjatë vitit 2018, në sektorin ujësjellës kanalizime kanë ushtruar veprimtarinë e tyre 57 shoqëri për kategorinë e shërbimit të "grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik". Nga këto shoqëri vetëm 2 prej tyre disponojnë licencë edhe kategorinë e "përpunimit të ujit të pijshëm për konsum publik", 48 prej tyre edhe atë të "grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura", dhe vetëm 4 shoqëri UK disponojnë në licencë edhe kategorinë e "përpunimit të ujërave të ndotura". Në vendin tonë për vitin 2018 ishin në funksion tetë (8) impiante të përpunimit të ujërave të ndotura, katër (4) prej të cilave nuk ishin të licencuara nga ERRU. Këto të fundit akoma nuk kanë arritur ende të plotësojnë kërkesat për plotësimin e dokumentacionit përkatës që duhet të paraqesin pranë ERRU-së për marrjen e licencës për këtë kategori shërbimi. Gjatë vitit 2018 kanë aplikuar për licencë apo rinovim të saj tridhjetë e pesë (35) shoqëri UK në total. Arsyet kryesore të kërkesës për licencim kanë qenë: a) përfundimi i afatit të licencës: kanë aplikuar 17 (shtatëmbëdhjetë) shoqëri; b) ndryshimi i zonës së shërbimit pas reformës administrative-



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

territoriale: kanë aplikuar 5 (pesë) shoqëri; c) shtim të kategorisë C, për largimin e ujërave të ndotura: kanë aplikuar 6 (gjashtë) shoqëri; d) ndryshimet në drejtuesit ligjor dhe/ose teknik: kanë aplikuar 6 (gjashtë) shoqëri; e) krijimi i shoqërive të reja: kanë aplikuar 4 (katër) shoqëri përkatësisht: Sh.a UK Finiq dhe Sh.a UK Dropull, Sh.a UK Konispol dhe sh.a UK Pustec.

Si përfundim, gjatë vitit 2018 KKRR ka licencuar njëzet e pesë (25) shoqëri, ndërsa dhjetë (10) aplikime të tjera mbeten në proces. Aplikimet në proces janë për arsye se ende këto shoqëri nuk kanë plotësuar kërkesat në zbatimit të VKM nr. 958 për liçensimin e operatorëve nga ERRU në fushën e ujësjellës kanalizimeve, përkatësisht për :

- Marrjen e akt-miratimit higjeno-sanitar, nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor. Kjo ka ardhur kryesisht sepse shoqëritë kanë zgjeruar zonën e shërbimit me zona shtesë rurale që kanë asete mjaft të amortizuara të sistemeve të furnizimit me ujë, si dhe shoqëritë e reja të krijuara rishtas në sektor, përkatësisht Pustec, Kamëz dhe Klos;

- Emërimin e drejtuesve teknikë, të kualifikuar sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 958; Vështirësitë që shoqëritë po hasin për përmbushjen e këtyre kushteve vazhdojnë të jenë pengesat kryesore për licencimin dhe rinovimin e licencës në kohë të shoqërive UK.

Situata e licencimit deri në fund të vitit 2018 për 57 shoqëritë UK është si më poshtë:

- Dyzet e dy (42) operatorë disponojnë licenca të vlefshme;
- Dhjetë (10) operatorë janë në proces të rinovimit të licencës;
- Tre (3) operatorë janë me licencë të pavlefshme dhe që nuk kanë aplikuar për rinovim licence, përkatësisht Sh.a UK Pukë, Sh.a U Divjakë, Sh.a UK Peqin, të cilat kanë probleme me regjistrimin dhe përditësimin në QKB, ndërsa Sh.a UK Peqin për shkak të problemeve me cilësinë e ujit dhe nuk arrin të pajiset me akt-miratimin higjeno-sanitar.
- Dy (2) operatore janë të rinj dhe nuk janë pajisur asnjëherë me licencë, UK Kamëz dhe UK Klos pasi nuk kanë plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për licencim.

Objektivi kryesor i ERRU-së në procesin e miratimit të tarifave është gjetja e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit. Nevoja e ndryshimit të tarifave për shoqëritë UK argumentohet nga:

- Parashikimet e pikës 3 të kreut II të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" ku parashikohet detyrimi i shoqërive UK për rishikimin e nivelit tarifor pas riorganizimit.

- Nevoja për unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit konstatohet në një pjesë të konsiderueshme të aplikimeve për ndryshim të tarifave. Ka patur dhe aplikime ku shoqëritë propozojnë tarifa të diferencuara midis zonës ekzistuese dhe asaj të shtuar, kjo për faktin se tarifat duhet t'i përgjigjen shërbimit të ofruar.

- Përmirësimi i situatës financiare të shoqërive pasi riorganizimi ka sjellë edhe një përkeqësim të financave të shoqërive. Shoqëritë e riorganizuar e kanë detyrim ligjor që të aplikojnë pranë ERRU-së, për miratimin e tarifave të reja, për unifikim të tyre, por dhe për tarifa të diferencuara për zonën ekzistuese si dhe për zonat e reja që ato kanë marrë në ngarkim kryesisht zonat rurale. Justifikimi bazë për tarifat e diferencuara është kryesisht diferenca në nivelin e shërbimeve të zonave të reja rurale që në zbatim të reformës i janë shtuar zonës së shërbimit të shoqërive.

Janë audituar me zgjedhje 15 dosje të pajisjes me licencim, ku konstatohet se dosjet përmbajnë gjithë dokumentacionin e kërkuar për licencim.

Nga auditimi konstatohet se dosjet nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat.

Gjatë vitit 2019, në sektorin ujësjellës kanalizime kanë ushtruar veprimtarinë e tyre 57 shoqëri për kategorinë e shërbimit të "grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik". Nga këto shoqëri vetëm 2 prej tyre kryejnë "përpunimin e ujit të pijshëm për konsum publik", 52 prej tyre edhe atë të "grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura" dhe vetëm 4 shoqëri UK disponojnë në licencë kategorinë e "përpunimit të ujërave të ndotura". Në vendin tonë për vitin 2019 kanë qenë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

në funksion tetë (8) impiante të përpunimit të ujërave të ndotura, katër (4) prej të cilave nuk janë të licencuara nga ERRU. Këto të fundit nuk kishin arritur ende të plotësonin kërkesat për plotësimin e dokumentacionit përkatës që duhet të paraqesin pranë ERRU-së për marrjen e licencës për këtë kategori shërbimi. Gjatë vitit 2019 ERRU ka pranuar njëzetë e pesë (25) aplikime për licencë nga 17 shoqëri UK sepse disa prej tyre, përkatësisht, UK si Gjirokastër, Dibër, Berat - Kuçovë dhe Vau i Dejës kanë aplikuar 2 herë, si për arsye ndryshimi drejtuesi ligjor/ drejtuesi teknik edhe për mbarim afati. Në detaje arsyet kryesore të aplikimeve për licencim kanë qenë: a) përfundimi i afatit të licencës për të cilën kanë aplikuar 10 (dhjetë) shoqëri; b) ndryshimet në drejtuesit ligjor dhe/ose teknik për të cilën kanë aplikuar 13 (trembëdhjetë) shoqëri; c) aplikim për herë të parë kanë aplikuar 2 (dy) shoqëri, përkatësisht U Këlcyrë dhe UK Pustec. Ndër shoqëritë që kanë aplikuar gjatë viti 2019 për shkak të skadimit të afatit të licencës vitet e shkuara, shkaqet kryesore të vonesës kanë konsistuar në mosarritjen e përbushjes së kushteve, si më poshtë:

- UK Këlcyrë, (u licencua për herë të parë) pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme ndër vite nuk ka arritur të plotësonte dokumentacionin përkatës, si për mos regjistrimin në QKB për inventarin e aseteve, mos pajisjen me Akt Miratimin Higjiene Sanitar, Drejtues teknik me kualifikimin e nevojshëm.

- UK Mallakastër, e licencuar rishtas pas një kalvari të gjatë të procedurave me Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për shkak të pamundësisë së reflektimeve ndër vite të ndryshimeve të ndodhura në shoqëri, kryesisht të ish anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës.

- UK Peqin, e licencuar rishtas pas përpjekjeve të vazhdueshme për tu pajisur me Akt Miratimin Higjiene Sanitar nga mos përbushja e treguesve të fortësisë së ujit në burim.

- UK Fushë Arrëz, e licencuar rishtas me vonesë për shkak se nuk arrinte të gjente një drejtues teknik sipas kërkesave të VKM-së së licencimit.

Gjithsesi nga 17 shoqëritë UK të licencuara nga ERRU gjatë vitit 2019, shtatë (7) prej tyre, nuk e kanë përfunduar atë për të gjithë territorin administrativ të bashkisë. Përkatësisht për shoqëritë UK Himarë dhe UK Fushë Arrëz arsyeja kryesore ka qenë moskryerja e inventarit të plotë të aseteve të shoqërisë kryesisht për zonat shtesë rurale mbas riorganizimit, si për shkak të mungesës së informacionit por edhe të fondeve të nevojshme që kërkon ekspertiza për këtë qëllim. Shoqëritë UK Mallakastër, UK Përmet dhe UK Fier nuk kanë arritur të përftojë *Akt Miratimin Higjiene Sanitar* për të gjithë zonën e shërbimit/administrative të bashkisë. Ndërkohë shoqëritë UK Peqin dhe UK Këlcyrë kanë licencë të kufizuar vetëm për pjesën e territorit që disponohen asete të inventarizuara të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Si përfundim, gjatë vitit 2019 nga KKRR janë marrë njëzet (20) Vendime licencimi në favor të (17) shoqërive, ndërsa nga njëzet e pesë (25) aplikime në total të paraqitura pranë ERRU-së mbeten akoma në proces pesë (5) prej tyre. Për të gjithë Sektorin e Ujesjelles Kanalizimeve përbërë nga 57 shoqëri UK, situata e licencimit deri në fund të vitit 2019, paraqitet, si më poshtë:

- Dyzet e nëntë (49) operatorë disponojnë licenca të vlefshme, pavarësisht se 3 prej tyre janë në proces aplikimi për ndryshim të drejtuesit teknik të tyre;

- Dy (2) operatorë janë në proces të rinovimit të licencës, *nuk po arrijnë të pajisen me Akt Miratimin Higjiene - Sanitar*.

- Katër (4) operatorë janë me licencë të pavlefshme dhe nuk kanë aplikuar gjatë vitit për rinovim licence, për arsye se: - U Divjakë ka probleme me regjistrimin dhe përditësimin në QKB. Kjo është një shoqëri që edhe pse ERRU ka zhvilluar disa takime dhe me pas dhe inspektim ku në mbështetje të saj i kërkoi që të vinin të licencoheshin për zonën ekzistuese, por shoqëria nuk bëri asnjë përpjekje dhe për këtë KKRR doli me vendimin e masës administrative me gjobë.

- UK Mirditë i mbaroi afati i licencës në nëntor të vitit 2019 dhe nuk arriti të plotësonte dosjen për rinovim licence.

- UK Selenicë nuk është riorganizuar ende. Problematika është mos përditësimi i QKB dhe kalimi në një nivel administrimi si dhe shtyrja e afateve të Këshillit të Administrimit, si dhe borxhet e mëdha të pashlyera.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

- UK Bulqizë nuk është riorganizuar ende. Sipas reformës duhej të bashkohej me UK Krastë, gjithashtu problematikë është mos pajisja me *akt miratim Higjenu – Sanitar për zonat e reja* që ka marrë nga reforma.

- Dy (2) operatorë janë të rinj dhe nuk janë pajisur asnjëherë me licencë, UK Kamëz dhe UK Klos pasi nuk kanë plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për licencim. Siç u përmend më sipër dy nga aplikimet që janë akoma në proces mbeten problematike sepse këto shoqëri momentalisht e kanë të pamundur të plotësojnë kërkesat për licensim të shoqërive UK në zbatimin të VKM nr. 958, përkatësisht për:

- Marrjen e akt-miratimit higjenu-sanitar, nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor. Kjo ka ardhur kryesisht sepse shoqëritë kanë zgjeruar zonën e shërbimit me zona shtesë rurale që kanë asete mjaft të amortizuara të sistemeve të furnizimit me ujë.

- Emërimin e drejtuesve teknikë, të kualifikuar sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 958; Vështirësitë që shoqëritë po hasin për përmbushjen e këtyre kushteve vazhdojnë të jenë pengesat kryesore për licencimin dhe rinovimin e licencës në kohë të shoqërive UK.

Procedura për vendosjen e tarifave fillon me propozimin e bërë nga i licencuari, dhënien e mendimit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, zhvillimin e seancës dëgjimore me publikun (konsumatorët) në zonën e shërbimit, dhe vazhdon me analizën nga stafi teknik i ERRU-së dhe diskutimin dhe miratimin e tyre përfundimtar me Vendim të veçantë nga Komisioni Kombëtar Rregullator. Për të bërë të mundur realizimin e këtij procesi, Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), bazuar në kompetencat që i jep ligji, ka miratuar nën-aktet ligjore përkatëse të detyrueshme që lidhen me mënyrën e aplikimit nga shoqëritë, analizën dhe miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, përkatësisht:

- Vendimi nr. 39, datë 09.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" ;

- Vendimi nr. 40, datë 09.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura";

- Vendimi nr. 41, datë 09.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura";

- Vendimi nr. 42, datë 09.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura";

Shoqëritë e riorganizuar e kanë detyrim ligjor që të aplikojnë pranë ERRU-së, për miratimin e tarifave të reja, për unifikim të tyre, por dhe për tarifa të diferencuara brenda zonës së shërbimit duke patur parasysh diferencat në cilësinë e shërbimit brenda saj, kryesisht ato ndërmjet zonave urbane dhe atyre rurale. Gjatë vitit 2019 kanë përfunduar procedurën dhe janë marrë vendimet për miratimin e tarifave të reja për 12 shoqëri ujësjellës kanalizime .

Me përjashtim të shoqërisë UK Malësi e Madhe e cila ka aplikuar gjatë vitit 2019 për nivel tarifor vetëm për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura, 11 shoqëritë e tjera kanë qenë në proces aplikimi nga viti kaluar 2018 dhe kanë aplikua bazuar në bilancin vjetorë të certifikuar nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar për vitin 2018. Deri në mbyllje të vitit 2019 nuk ka asnjë shoqëri tjetër që të ketë filluar procedurën e aplikimit për tarifa dhe të jetë në proces shqyrtimi pranë ERRU. Argumentimi bazë i aplikimeve nga Shoqëritë UK gjatë vitit 2019 ka konsistuar kryesisht në:

- Përmbushjen e detyrimit ligjor që shoqëritë duhet të aplikojnë tarifa të reja sipas parashikimeve të pikës 3 të kreut II të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", nga nevoja për unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit të tyre. Mbas riorganizimit përshoqëritë në zonën e re të shërbimit ekzistojnë tarifa të ndryshme në vende të ndryshme të njësisë së administrative (ish komunat) që duhen unifikuar, ose mungesa e tyre për zonat që dikur nuk janë shërbyer nga asnjë shoqëri UK.

Në procesin e aplikimeve dhe të analizës për propozimet për tarifa të reja gjithsesi mbetet akoma problem pasaktësia e informacionit si dhe mangësitë në dokumentacion. . Kjo gjë ka bërë që analizat dhe vendimmarrjet për këto shoqëri të zgjaten në afatet kohore, derisa të plotësohet



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

dokumentacioni në përputhje me standardet e përcaktuara në Metodologjinë e Vendosijes së Tarifave. Saktësia e të dhënave luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e tarifave. Rritja e besueshmërisë së të dhënave vazhdon të mbetet një shqetësim dhe nga ana tjetër prioritet i punës së ERRU-së, reflektuar kjo në analizën teknike ekonomike të aplikimeve për miratim tarifash për shërbimet UK. Për këtë arsye ERRU gjatë vitit 2019 ka organizuar mbledhjen e përpunimit e të dhënave direkt nga shoqëritë dhe llogaritjen e Treguesve të Performancës të cilat shërbejnë për një analizë të ecurisë së shoqërisë, si edhe për përcaktimin e objektivave që shoqëria duhet të përmbushë në të ardhmen. Kriteri tjetër bazë që ERRU ka gjatë analizës së vlerësimit të tarifave të reja është ai i Përbalueshmërisë së faturës nga ana e konsumatorit në mbrojtje të interesave të tij. ERRU përdor si kriter për përbalueshmërinë e pagesës së faturës së shërbimeve UK, nivelin prej 5% të të ardhurave (shpenzimeve) mesatare mujore të një njësie ekonomike familjare, informacion që e kalkulon dhe e publikon INSTAT “Anketa e Buxhetit të familjes viti 2017”, për të gjithë qarqet e Republikës së Shqipërisë. Të dhënat e INSTAT nga “Anketa e Buxhetit të familjes viti 2018” nuk kanë qenë të disponueshme gjatë vitit 2019 për tu përdorur si kriter për Përbalueshmërinë, kështu që është operuar me ato të vitit 2017. Trajtimi i problemit të përbalueshmërisë bazuar në të dhënat e INSTAT është mënyra më objektive e vlerësimit të tij, mënyrë e cila jep një tablo më të qartë edhe të reagimit të pritshëm nga publiku kur propozohet rritja e tarifave, si dhe të ndërtimit të politikave sociale nga qeveria qendrore dhe ajo lokale. Përgjithësisht trendi i ndryshimit të tarifave ka qenë rritës por në vendimmarrjet e vitit 2019 në ndonjë rast të veçantë rishikimi i tarifave për kategori të ndryshme të konsumatorëve ka patur dhe tendencë për tarifa më të ulëta se ekzistueset.

Janë audituar me zgjedhje 15 dosje të pajisjes me licencim, ku konstatohet se dosjet përmbajnë gjithë dokumentacionin e kërkuar për licencim.

Nga auditimi konstatohet se problematikë në licencim është mos pajisja me akt miratim Higjeno - Sanitar për të gjithë zonat e shërbimit, duke çuar në vonesa në procedurën e pajisjes me licencim dhe gjithashtu garancisë së sigurisë së shëndetit publik për uljen e rrishtit të kontaminimit të rrjeteve shpërndarëse të ujës jellësit, pasi edhe duke mos e pasur këtë licensë dhe deri në momentin e marrjes së saj UK e zhvillojnë aktivitetin e tyre .

Nga auditimi konstatohet se dosjet nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat.

Më poshtë paraqitet tabela e operatorëve të pa licencuar deri në Maj të vitit 2020, si dhe problematikat përkatëse të mos licencimit ku vihet re se një nga problematikat kryesore është mos pajisja me akt miratim Higjeno – Sanitar.

Operatore pa licence dhe ne proces deri ne Maj 2020			
Nr.	Operatori	Licencimi	Shpjegime
<b>Në proces</b>			
1	Tirane UK sh.a	Ne proces	Problematika është mos pajisja me akt miratim Higjeno - Sanitar për të gjithë zonën e shërbimit.
2	Pustec UK sh.a	Ne proces	Shoqëri e re e krijuar sipas reformës Administrative Territoriale Problematika është mos pajisja me akt miratim Higjeno - Sanitar.
3	Mirdite UK sh.a	Ne proces	Sipas reformës. Problematika është mos kryerja e pagesës së licencimit pasi shoqërisë i janë bllokuar llogarite bankare nga tatimet dhe nuk operon dot për momentin.
<b>Pa licensë të vlefshme</b>			
4	Bulqize U sh.a	Pa licence	I ka mbaruar afati i licensës. Problematike për



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

			ketë shoqëri është mos pajisja me akt miratim <b>Higjeno - Sanitar.</b>
5	Divjake UK sh.a	Pa licence	Problematika është neglizhenca nga ana e shoqërisë për plotësimin e dokumentacionit për licencim ku pas shume përpjekjeve nga ana jone është marre edhe mase administrative gjobe ndaj saj .
6	Selenice U sh.a	Pa licencë	I ka mbaruar afati i licencës. Shoqëria nuk është riorganizuar akoma sipas reformes. Problematika është mos përditësimi i QKB dhe kalimi ne nje nivel administrimi si dhe shtyrja e afateve te Keshillit te administrimit. Gjithashtu kjo shoqeri ka edhe veshtiresi te theksuara financiare te cilat e pengojne ne operimin normal te saj.
<b>Pa licencë</b>			
7	Kamez UK	Nuk kane aplikuar per licencim	Shoqeri e re e cila eshte krijuar sipas reformes ne fund te viiti 2019 por akoma nuk ka paraqitur dokumentacionin per aplikim.
8	Klos UK sh.a.	Nuk kane aplikuar per licencim	Shoqeri e re e cila do te krijohet sipas reformes por akoma operon si ndermarrje prane bashkise nuk jane krijuar si Sh.a. pasi bashkia nuk ka filluar procedurat perkatese.

<b>Titulli i Gjetjes 3:</b>	<i>Plotësimi i organikës</i>
<b>Situata:</b>	Nga auditmi konstatohet se problematikë në licencim është mos pajisja me akt miratim Higjeno - Sanitar per te gjithe zonat e shërbimit, duke çuar në vonesa në procedurën e pajisjes me licencim dhe gjithashtu garancisë së sigurisë së shëndetit publik për uljen e rriskut të kontaminimit të rrjeteve shpërndarëse të ujësjellësit, pasi edhe duke mos e pasur këtë licensë dhe deri në momentin e marrjes së saj UK e zhvillojnë aktivitetin e tyre .
<b>Kriteri:</b>	<i>VKM nr. 958 për liçensimin e operatorëve nga ERRU në fushën e ujësjellës kanalizimeve</i>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Vonesa në procedurën e pajisjes me licencim dhe gjithashtu garancisë së sigurisë së shëndetit publik për uljen e rriskut të kontaminimit të rrjeteve shpërndarëse të ujësjellësit, pasi edhe duke mos e pasur këtë licensë dhe deri në momentin e marrjes së saj UK e zhvillojnë aktivitetin e tyre .
<b>Shkaku:</b>	Mos pajisja me akt miratim Higjeno - Sanitar per te gjithe zonat e shërbimit.
<b>shRëndësia:</b>	I mesëm

#### 6. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE DHE TARIFAVE TË SHITJES SË UJIT ME PAKICË DHE SHUMICË TË UJRAT E PËRDORUR DHE TRAJTIMIT TË TYRE.

Në zbatim të ligjit nr. 8102, ERRU është autoriteti që miraton tarifave të shërbimeve UK si dhe përcakton metodologjinë e përlogaritjes së tarifave. Procedura për vendosjen e tarifave fillon me propozimin e bërë nga i licencuari, dhënie e mendimit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, marrja e informacionit mbi opinionet dhe reagimet e konsumatorëve gjatë seancës dëgjimore me publikun që zhvillon shoqëria, dhe përfundon me miratimin përfundimtar të tarifave nga Enti Rregullator i Ujit.

Gjatë vitit **2018** kanë përfunduar procedurën dhe janë marrë vendimet për miratimin e tarifave të reja për shoqëritë në Tabelën 1.

Nr	Operatori	Viti i Aplikimit	Numri i Vendimit të	Data
----	-----------	------------------	---------------------	------



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

			ERRU-së	
1	UK Malësi e Madhe	2017	10	16.02.2018
2	UK Maliq	2017	11	16.02.2018
3	UK Gramsh	2017	33	11.05.2018
4	UK Skrapar	2017	34	11.05.2018
5	UK Vau Dejës	2018	74	19.10.2018
6	UK Librazhd - Prrenjas	2018	75	19.10.2018
7	UK Poliçani	2018	Projekt Vendim	17.12.2018
8	UK Gjirokastrë	2018	Projekt Vendim	07.12.2018

Tabela e mëposhtme paraqet një situatë të përmblëdhur të aplikimeve për ndryshimin e tarifave.

Tabela 2. Shoqëritë në Proces për Ndryshimin e Tarifave

Nr.	Operatori	Faza e Aplikimit	Shënime
1	UK Himara	Vendimi nr.76 datë 06.11.2018 për fillimin e procedurës	Në proces të Analizës Teknike Ekonomike
2	UK Lushnje	Vendimi nr.63 datë 06.09.2018 për fillimin e procedurës	Në proces të Analizës Teknike Ekonomike
3	UK Vlorë	Vendimi nr.73 datë 01.10.2018 për fillimin e procedurës	Në proces të Analizës Teknike Ekonomike
4	UK	Roskovec Vendimi nr. 79 datë 26.11.2018 për fillimin e procedurës	Në proces të Analizës Teknike Ekonomike
5	UK Delvinë	Vendimi nr. 60 datë 06.09.2018 për fillimin e procedurës	Në proces të Analizës Teknike Ekonomike
6	UK Krujë	Vendimi nr. 72 datë 01.10.2018 për fillimin e procedurës	Në proces të Analizës Teknike Ekonomike
7	UK BeratKuçovë	Shtyrje afati sipas konkluzioneve të mbledhjes së KKRR datë 19.10.2018	Analiza teknike-ekonomike shtyhet në vitin 2019 për saktësim të të dhënave
8	UK Bulqizë	Aplikimi nr.19 prot. datë 24.01.2018	Mungon dokumenti "Leje Higjieno Sanitare" për licensim. Në pritje të njoftimit për zhvillimin e Seancës Dëgjimore me publikun.
9	UK Pustec	Aplikimi nr.14 prot, datë 08.02.2018	Në pritje të Lejes Higjieno Sanitare për licensim
10	UK Vorë	Aplikimi nr.577 prot, datë 26.06.2018	Mungon procesverbali i zhvillimit të seancës dëgjimore
11	UK Tropojë	Aplikimi nr. 119 prot, datë 19.12.2018	Është në fazën e plotësimit të dokumentacionit

Komisioni Kombëtar Rregullator, gjatë vitit 2018, ka marrë vendime për mos shqyrtim të aplikimeve për ndryshimin e tarifave dhe riaplikim, pasi shoqëritë nuk kanë arritur të plotësojnë dokumentacionin sipas afateve kohore të përcaktuara nga ERRU, përkatësisht për shoqëritë UK Shkodër, UK Krujë dhe UK Fier.

Gjatë analizës të aplikimeve dhe aprovimit të tarifave të reja nga shoqëritë UK, ERRU ka pasur parasysh një kompleks faktorësh, si: shpenzimet, normën e arkëtimit, tendencën e performancës së shoqërisë, përbërjen e zonës së shërbimit (rurale, urbane), si dhe veçori të sistemeve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve të ujërave të ndotura, mosha e aseteve, gjendja e tyre që influencën mjaft në nevojat për investime





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

urgjente dhe afatmesme, shlyerja e detyrimeve ndaj kredi dhënësve për investimet e kryera, etj. Në mjaft raste, shoqëritë vazhdojnë të paraqesin aplikimet për ndryshimin e tarifave me mangësi në dokumentacion dhe me pasaktësi në të dhënat. Kjo bën që dhe analizat si dhe vendimmarrjet për këto shoqëri të zgjaten në afatet kohore, derisa të plotësohet dokumentacioni në përputhje me standardet e përcaktuara në metodologjinë e vendosjes së tarifave

Nga auditimi i dosjeve u konstatua se dosjet përbajnë gjithë dokumentacionin e kërkuar për aplikimin e tarifave të reja.

-U konstatua se se të gjitha dosjet e audituara nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat.

#### Viti 2019

Gjatë vitit 2019 kanë përfunduar procedurën dhe janë marrë vendimet për miratimin e tarifave të reja për 12 shoqëri ujësjellës kanalizime si në Tabelën 2.

Nr.	Operatori	Numri i Vendimit të KKRR	Data e Vendimit
1	UK Gjirokastër	7	08.02. 2019
2	UK Poliçan	8	08.02.2019
3	UK Delvinë	13	06.03.2019
4	UK Tropojë	29	28.06.2019
5	UK Malësi e Madhe	30	28.06.2019
6	UK Lushnje	41	28.08.2019
7	UK Berat-Kuçovë	48	10.10.2019
8	UK Vlorë	51	28.10.2019
9	UK Krujë	52	28.10.2019
10	UK Himarë	53	28.10.2019
11	UK Vorë	68	19.12.2019
12	UK Roskovec	69	30.12.2019

Me përjashtim të shoqërisë UK Malësi e Madhe e cila ka aplikuar gjatë vitit 2019 për nivel tarifor vetëm për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura, 11 shoqëritë e tjera kanë qenë në proces aplikimi nga viti kaluar 2018 dhe kanë aplikua bazuar në bilancin vjetorë të certifikuara nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar për vitin 2018.

Deri në mbyllje të vitit 2019 nuk ka asnjë shoqëri tjetër që të ketë filluar procedurën e aplikimit për tarifa dhe të jetë në proces shqyrtimi pranë ERRU. Argumentimi bazë i aplikimeve nga Shoqëritë UK gjatë vitit 2019 ka konsistuar kryesisht në:

- Përmbyshjen e detyrimit ligjor që shoqëritë duhet të aplikojnë tarifa të reja sipas parashikimeve të pikës 3 të kreu II të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", nga nevoja për unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit të tyre. Mbas riorganizimit për shoqëritë në zonën e re të shërbimit ekzistojnë tarifa të ndryshme në vende të ndryshme të njësisë së re administrative (ish komunat) që duhen unifikuar, ose mungesa e tyre për zonat që dikur nuk janë shërbyer nga asnjë shoqëri UK.

- Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, që i jep të drejtën Shoqërive të aplikojnë për tarifa të reja nga nevoja për rritjen e qëndrueshmërisë financiare të tyre.

ERRU gjatë analizës së aplikimeve për aprovimin e tarifave të reja nga shoqëritë UK ka parasysh kriterin që me nivelin tarifor të miratuar të synohet mbulimi i kostove të O&M, dhe për shoqëri më të avancuara në drejtim të qëndrueshmërisë financiare, të mbulohen edhe Kostot Totale që



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

përfshijnë dhe nevojat për investime fizike. Këto kosto duhet të mbulohen me të ardhura bazuar gjithashtu në një Normë Arkëtimi të arsyeshme (pranueshme) të faturave të klientëve.

Kriteri tjetër bazë që ERRU ka gjatë analizës së vlerësimit të tarifave të reja është ai i Përballeshmërisë së faturës nga ana e konsumatorit në mbrojtje të interesave të tij. ERRU përdor si kriter për përballeshmërinë e pagesës së faturës së shërbimeve UK, nivelin prej 5% të të ardhurave (shpenzimeve) mesatare mujore të një njësie ekonomike familjare, informacion që e kalkulon dhe e publikon INSTAT “Anketa e Buxhetit të familjes viti 2017”, për të gjithë qarqet e Republikës së Shqipërisë. Të dhënat e INSTAT nga “Anketa e Buxhetit të familjes viti 2018” nuk kanë qenë të disponueshme gjatë vitit 2019 për tu përdorur si kriter për Përballeshmërinë, kështu që është operuar me ato të vitit 2017.

Nga auditimi i dosjeve u konstatua se dosjet përbajnë gjithë dokumentacionin e kërkuar për aplikimin e tarifave të reja.

U konstatua se se të gjitha dosjet e audituara nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat.”

<b>Titulli i Gjetjes 2:</b>	<i>Inventarizimi i dosjeve</i>
<b>Situata:</b>	Në Institucionin ERRU rezultoi se dosjet e procedurave të licensimit të personave fizik e juridik dhe dosjet e përcaktimit të çmimeve dhe tarifave të shitjes së ujit me pakicë dhe shumicë të ujrave të përdorur dhe trajtimit të tyre nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara. -Dosjet personale të nëpunësve nuk janë inventarizuar, administruar me indeks të vecantë, ku të evidentohen shkresat e fashikujt në vecanti si dhe pasqyrimi kronologjik i numrit të fletëve në dosje.
<b>Kriteri:</b>	<i>Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat.”</i> VKM Nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit”, Format Standard nr.17,
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mosarkivimi i dosjeve sjell mungesë transparence dhe mund të jetë precedent i humbjes së materialeve që përmbajnë dosjet përkatëse
<b>Shkaku:</b>	Mos inventarizimi i dosjeve
<b>shRëndësia:</b>	I mesëm

## 8. PROKURIMET E FONDEVE PUBLIKE

*Nga auditimi i këtyre procedurave me zgjedhje, u konstatua se:*

1. Në të gjitha rastet e përdorimit të formës së prokurimit “Blerje me vlerë të vogël”, fondi limit ka qenë deri në 800,000 lekë pa TVSH. pra brenda kufirit monetar të përcaktuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu II, pika 2 si dhe udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, Udhëzimit nr 3, dt 08.01.2018 të APP “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, Udhëzimit nr. 11, dt 30.05.2018 të APP , Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 3, dt 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, të ndryshuar.

2. Nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është zbatuar limiti i përcaktuar për prokurimet me vlera të vogla i cili nuk është tejkaluar në asnjë rast.

3. Në dosjen e prokurimeve me vlera të vogla ndodheshin faturat tatimore shitje të cilat rezultuan të njëjta me vlerën e ofertuar si dhe me urdhër shpenzimet përkatëse.

4. Titullari I institucionit me urdhrat nr 1 datë 08.01.2018, nr 6 datë 15.01.2019 dhe nr 2 datë 13.01.2020 ka ngritur komisionin e prokurimit për blerje me vlera të vogla. Kryetar I komisionit gjatë periudhës object auditimi është z.Illir Vuka, specialist në sektorin juridik. Anëtar janë zj.Ermela Xherri specialist në sektorin e performancës, zj.Elda Kruja specialist në sektorin e tarifave dhe për vitin 2020 zj Fjola Beqiri.

5. Titullari i institucionit nuk ka nxjerë urdhër të brendshëm për ngritjen e komisionit të marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve të prokuruar në Blerjet me Vlerë të Vogël për periudhen 2018-qershor 2019. Kjo bie në kundërshtim me *Udhëzimin Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

*Menaxhimin E Aktiveve Në Njësitë E Sektorit Publik”, Dokumentimi I Levizjes Se Aktiveve, Pika 34. “Veprimet ekonomike që kryhen në njesite publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjehere pasi kryhet veprimi” dhe pika nr 35 “Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumenta origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në: Dokumenta autorizues - janë ato dokumenta që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Te tilla jane, urdherat për krijimin e komisioneve, et”.*

6. Nga personat e marrjes në dorëzim të mallrave nuk janë mbajtur procesverbalet e marrjes në dorëzim për kontrollin fizik të mallrave në sasi dhe cilësi të cilat ndodheshin fletë hyrjet e magazinës me vlera të njëjta me faturat tatimore të shitjes përgjatë vitit 2018-qershor 2019. Kjo bie në kundërshtim me *Vendimin Nr. 914, Datë 29.12.2014 Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik, Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, pika 3. “Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit”.*

*Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm për periudhën 2018-30.04.2020 në vija të përgjithshme rezultoi:*

Për periudhën e vitit 2018 janë realizuar gjithsej 14 procedura prokurimi me vlerë të vogël, ku 7 prej tyre janë nën vlerën 100,000 lekë dhe 7 të tjera midis vlerës 100,000-800,000 lekë. Kryesisht janë zhvilluar prokurime për blerjen e materialeve të zyrës, kancelari, riparim ambjentesh etj. Është zhvilluar dhe një procedurë kërkesë për propozim blerje automjeti me fondin limit 6,083,333.00 lekë

NR	Objekti i Prokurimit	Tipi i kontratës Shërbim/Malli/Puna	Fondi Limit	Lloji i Procedurës së Prokurimit	Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit
1	Aktivite,ëorkshop	Shërbim	430,000	Blerje me vlerë të vogël	06.03.2018
2	Blerje automjeti	mall	6,083,333	Kërkesë për propozim	26.02.2018
3	Blerje bileta transporti	shërbim	714,583	Bl.vlerëtë vogël	16.03.2018
4	Blerje kancelari	mall	87,500	Bl.vlerëtë vogël	31.10.2018
5	Blerje karburant	mall	262,500	Bl.vlerëtë vogël	31.08.2018
6	Blerje,materiale,pastrimi	mall	100,000	Bl.vlerëtë vogël	02.07.2018
7	Blerje uji	mall	75,000	Bl.vlerëtë vogël	19.02.2018
8	Botim raporti ERRU	Shërbim	100,000	Bl.vlerëtë vogël	02.02.2018
9	Mirëmbajtje paisjesh	Shërbim	81,250	Bl.vlerëtë vogël	04.12.2018
10	Parkim larje automjeti	Shërbim	113,333	Bl.vlerëtë vogël	30.03.2018
11	Shërbim interneti	Shërbim	250,000	Bl.vlerëtë vogël	16.02.2018
12	Shërbim auditimi	Shërbim	100,000	Bl.vlerëtë vogël	04.04.2018
13	Siguracion e taksa	Shërbim	112,500	Bl.vlerëtë vogël	23.02.2018
14	Siguracion e taksa	Shërbim	262,500	Bl.vlerëtë vogël	27.04.2018
15	Veshje dyersh	Shërbim	70,000	Bl.vlerëtë vogël	16.10.2018



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

### Regjistri i realizimit të prokurimeve publike për vitin 2018

Për vitin 2018 fondi i përlogaritur (pa TVSH) për realizimin e procedurave të prokurimeve ishte 8,959,998.00. Nga realizimi i procedurave të prokurimeve është shpenzuar 8.842.499.00 e fondit limit të parashikuar, ose 98,6% e fondit limit. Nga këto procedura u audituan me përzgjedhje 3 procedura Blerje e Vogël si dhe Kërkesa për propozim Blerje Automjeti me fond limit 6,083,333.00 lekë

#### **Blerje automjeti viti 2018 me nr reference 47565-02-14-2018**

- Me Urdhër nr. 11, datë 13.02.2018 është krijuar "Njësia e prokurimit për blerje automjeti për ERRU", i përbërë nga:

1. Ilir Vuka,
2. Elda Kruja,
3. Erind Kraja.

Me procesverbalin nr 1 datë 26.02.2018 është mbajtur hapja e ofertave nga tre OE pjesëmarrës, OE Hunday, OE Porsche Albania dhe OE Paera

Me Urdhër nr. 12, datë 13.02.2018 është krijuar "Komisioni i hapjes së ofertave për blerje automjeti për ERRU", i përbërë nga:

1. Engjellushe Murataj,
2. Sokol Kraja,
3. Astrit Nasufi

Nga auditimi i kësaj procedure rezulton se: me referencën nr 47565 datë 14.02.2018 me fond limit gjashtë milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre lekë pa TVSH është zhvilluar procedura e prokurimit kërkesë për propozim për blerjen e dy automjeteve për nevojat e institucionit. Kohëzgjatja e dorëzimit të mallit është 90 ditë nga lidhja e kontratës.

Observacion nga ana e subjektit

Përsa i përket gjetjes 1:

Njësia e Prokurimit ka tejkualuar kërkesat për kapacitete financiare

Pika c e nenit 46 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" parashikon se: *Operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevoje, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur.*

Sa më lart provohet se Njësia e Prokurimit nuk ka tejkualuar në asnjë moment kërkesat për kapacitet financiar për sa kohë që kërkesa për paraqitjen e deklaratës bankare është e përcaktuar shprehimisht në ligj, neni 46 pika c.

Pergjigje e KLSH

Mbi observacionin e gjetjes nr.1

Sqarojmë se, në Pikën c e nenit 46 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" *Operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare*, ligji nuk shprehet saktësisht mbi likuiditetin financiar 10% që ERRU ka kërkuar nga OE pjesëmarrës. Megjithatë shumica në likuiditet 10% e kërkuar është e arsyeshme për të vërtetuar kapacitetet ekonomike e financiare të OE pjesëmarrës.

**Duke vlerësuar se në cdo rast është kërkuar minimumi i likuiditetit financiar ky observacion meret në konsideratë.**

Observacion nga ana e subjektit

Përsa i përket gjetjes 2: *Njësia e prokurimit ka hartuar specifikime teknike fikse dhe nuk ka lënë hapsirë në hartimin e përmasave të automjetit duke kufizuar numrin e Operatorëve Ekonomikë pjesëmarrës.*

II	Përmasat	
1	Modeli karrocërisë	Foristrade
2	Gjatësia	Minimumi: 4400 mm
3	Lartësia	Minimumi: 1600 mm
4	Gjerësia	Minimumi: 1800 mm



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

5	Hapi ose distanca mes akseve	Minimumi: 2600 mm
---	------------------------------	-------------------

Siç shihet nga tabela e mësipërme, pjesë e dokumentave të tenderit, në lidhje me kushtet teknike për përmasat që duhet të përmbushë automjeti foristradë të dhënat *nuk përfaqësojnë shifra fikse, por vlera minimale* që i përkasin këtij lloji automjeti që duhet të mbulojë me shërbime të gjithë territorin e Republikës dhe më gjerë dhe në kushte rruge të vështira.

*Në rastin tonë provohet kërkesat në lidhje vetëm me minimumin e përmasave dhe duke mos kufizuar në asnjë rast maksimumin e tyre.*

Pergjigje e KLSH  
*Mbi observacionin e gjetjes nr.2*  
 Sqarojmë se, Në lidhje me kushtet teknike për përmasat që duhet të përmbushë automjeti Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara ka një udhëzues ku përmasat e kërkuara të njetit janë vetëm Gjatësia, Lartësia, 3.Gjerësia. Distanca ndërmjet akseve nuk është kriter i kërkuar. Këtë kriter e ka kërkuar Autoriteti Kontraktues pa sqaruar shkakun. por duke parë vetëm dy operatorë të kualifikuar pjesëmarrës këto kritere minimale kanë kufizuar garën. ERRU duhet të sqarojë në të ardhmen në dokumentat standarte të tenderit arsëyet e vendosjes së specifikimeve teknike.

**Duke vlerësuar se në cdo rast është kërkuar minimumi i përmasave ky observacion meret në konsideratë.**

#### Regjistri i realizimit te prokurimeve publike për vitin 2019

Për periudhën Janar-Dhjetor 2019 janë realizuar gjithsej 22 procedura prokurimi, ku 14 prej tyre janë nën vlerën 100,000 lekë dhe 8 të tjera midis vlerës 100,000-800,000 lekë. Kryesisht janë zhvilluar prokurime për blerjen e materialeve të zyrës, kancelari, riparim ambjentesh etj., fondit i përllogaritur ( pa TVSH) për realizimin e procedurave të prokurimeve ishte 4,236,000.00. Nga realizimi i procedurave të prokurimeve është shpenzuar 2,438,268.00 e fondit limit të parashikuar, ose 57,6% e fondit limit

NR	Objekti i Prokurimit	Tipi i kontratës Shërbim/Malli/Puna	Fondi Limit	Lloji i Procedurës së Prokurimit	Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit
1	Blerje bileta transporti	Mall	100,000	Blerje me vler të vogël	17.01.2020
2	Blerje,materiale,pastrimi	mall	141,250	Bl.vlerëtë vogël	17.02.2020
3	Blerje uji	Mall	54,000	Bl.vlerëtë vogël	23.01.2020
4	Botim raporti ERRU	Shërbim	238,333	Bl.vlerëtë vogël	29.01.2020
5	Mirëmbajtje automjeti	Shërbim	215,000	Bl.vlerëtë vogël	31.08.2020
6	Njoftime për shtyp	Shërbim	64,140	Bl.vlerëtë vogël	29.04.2020
7	Parkim e larje automjeti	mall	109,167	Bl.vlerëtë vogël	19.02.2020
8	Shërbim interneti	Shërbim	95,000	Bl.vlerëtë vogël	24.04.2020
9	Siguracion	Mall	237,500	Bl.vlerëtë vogël	24.04.2020

#### Regjistri i realizimit të prokurimeve publike për vitin 2020

Për periudhën Janar-Prill 2020 janë realizuar gjithsej 9 procedura prokurimi, ku 5 prej tyre janë nën vlerën 100,000 lekë dhe 4 të tjera midis vlerës 100,000-800,000 lekë. Kryesisht janë zhvilluar prokurime për blerjen e materialeve të zyrës, kancelari, riparim ambjentesh etj. fondit i përllogaritur ( pa TVSH) për realizimin e procedurave të prokurimeve ishte 5,010,709.00. Nga realizimi i procedurave të prokurimeve është shpenzuar 2,154,390.00 e fondit limit të parashikuar, ose 42,9% e fondit limit.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

- Me referencën nr 50362-02-13-2020 "Blerje materiale pastrimi" Enti Rregullator i Ujit ka zhvilluar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt: Blerje materiale pastrimi sipas tabelës më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia matëse	Sasia e kërkuar
1	Detergjent pastrim dezinfektim tualeti 1 litër	copë	8
2	Doreza pastrimi plastike shume përdorimshe	palë	5
3	Fshese pastrimi me shkop konik	copë	3
4	Detergjent Pastrimi 5 lt	copë	5
5	Peshqirë mikrofibër 40x10	copë	20

Në dosje konstatohet se në këtë procedura nuk administrohet kërkesa e sektorit përgjegjës të financës e shërbimeve mbështetëse për nevojën e këtyre materialeve

**Me referencat me nr 53651-03-10-2020** Enti Rregullator i Ujit ka zhvilluar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt: Blerje kancelari sipas tabelës më poshtë:

Nr	Emertimi	Njësia matese	Sasia e kërkuar
1	Bllok shenimesh A5	Cope	5.00
2	Axhende 2020	cope	20.00
3	Evidenciator	cope	25.00
4	CD	cope	50.00
5	DVD	cope	10.00
6	Stilolapsa per cd	cope	15.00
7	Zarfa per CD	cope	60.00

Në ftesën për ofertë rezulton se nga Komisioni Blerjeve të Vogla është kërkuar të sjellë nga një mostër për secilin produkt në momentin e paraqitjes në institucion. *"Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të plotësojë kriteret si më poshtë: Të sjellë nga 1 mostër për secilin produkt në momentin e paraqitjes në instiucion;*

Kjo bie në kundërshtim me pikën 8 të Udhëzimit nr 3 datë 08.01.2018 *"Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël autoriteti kontraktor nuk duhet të kërkojë paraqitjen e mostrave të mallit objekt prokurimi, pasi verifikimi i cilësisë së mallit bëhet në momentin e marrjes së mallit në dorëzim"*

Përsa sipër mban përgjegjësi AK.

Me referencat me nr **nr 53651-03-10-2020**, me nr **04465-01-21-2019** konstatohet se faturat tatimore të lëshuar nga operatori ekonomik i shpallur fitues, nuk janë nënshkruar ngatë gjithë anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla, në kundërshtim përcaktimet e bëra në pikën 7, të nenit 40 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për rregullat e prokurimit publik"*, i ndryshuar. Pika 7. *"Pagesa për prokurimet me vlerë të vogël bëhet sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të nënshkruhen nga anëtarët e komisionit"*.

<b>Titulli i Gjetjes 3:</b>	<i>Paraqitja e mostrave Procedurat e prokurimit</i>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i procedurave të blerjeve të vogla konstatohet se nga Komisioni Blerjeve të Vogla kërkohet që OE fitues të sjellin mostra për secilin produkt në momentin e paraqitjes në institucion në kundërshtim me bazën ligjore.
<b>Kriteri:</b>	<i>Udhëzimi nr 3 datë 08.01.2018 "Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël autoriteti kontraktor nuk duhet të kërkojë paraqitjen e mostrave të mallit objekt prokurimi, pasi verifikimi i cilësisë së mallit bëhet në momentin e marrjes së mallit në dorëzim"</i>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Kërkesa për paraqitjen e mostrave është në kundërshtim me bazën ligjore dhe con në uljen e pjesëmarrësve në procedurat e prokurimit të blerjeve të vogla
<b>Shkaku:</b>	Kërkesa për paraqitjen e mostrave në procedurat e blerjeve të vogla



shRëndësia:

I mesëm

**8.PROBLEME TË NDRYSHME QË MUND TË DALIN GJATË AUDITIMIT TË ÇDO DREJTORIE NË VEÇANTI DHE TË ERRU-SË NË TËRËSI.****8.1 PROCESET GJYQËSORE**

Gjatë vitit 2018 Enti Rregullator i Ujit ishte pjesë e 5 proceseve gjyqësore, 4 prej të cilave të iniciuara nga vetë ERRU me objekt shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të pagesës rregullatore nga ana e shoqërive ujësjellës kanalizime:

Aktualisht çështjet gjyqësore janë në fazat si më poshtë:

1. Res Publica, Pilo Prence – Enti Rregullator i Ujit, Bashkia Tiranë dhe Këshilli Bashkiak Tiranë. Palë paditëse: Res Publica dhe z. Pilo Prence Palë e paditur: Enti Rregullator i Ujit, Bashkia Tiranë dhe Këshilli Bashkiak Tiranë. Objekti: Shfuqizimi i Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 79, datë 26.07.2017 "Për dhënie mendimi për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm" dhe shfuqizimi i Vendimit nr. 47, datë 07.11.2017, "Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a." të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura. Kjo çështje u shqyrtua nga Gjykata Administrative e Apelit dhe pas disa seancave gjyqësore, në datën 24.12.2018 trupi gjykues shpalli vendimin duke rrëzuar kërkesë padinë si të pabazuar në ligj dhe prova dhe lënien në fuqi të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 79, datë 26.07.2017 "Për dhënie mendimi për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm" dhe Vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 47, datë 07.11.2017, "Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a."

**Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos rrëzimi i kërkesë padisë. Ky vendim ka marrë formë të prerë.**

2. Enti Rregullator i Ujit -Ujësjellës Kanalizime Kukës sh.a. Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit Palë e paditur: Ujësjellës Kanalizime Kukës sh.a. Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Kukës" sh.a. të paguajë shumën 295 000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

**Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos që shoqëria UK Kukës sh.a t'i paguajë ERRU shumën 295 000 lekë. Ky vendim ka marrë formë të prerë.**

3. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjellës Kanalizime Rrogozhine sh.a. Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit Palë e paditur: Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë sh.a. Objekti: Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë sh.a" të shlyejë shumën 778 200 lekë si një detyrim i prapambetur kontraktuar. **Kjo çështje nuk është shqyrtuar përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë gjatë vitit 2018.**

4. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjellës Kanalizime Krujë sh.a. Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit Palë e paditur: Ujësjellës Kanalizime Krujë sh.a. Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Krujë" sh.a. të paguajë shumën 1 586 200 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

**Kjo çështje nuk është shqyrtuar përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë gjatë vitit 2018.**

5. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjellës Kanalizime Peqin sh.a. Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit Palë e paditur: Ujësjellës Kanalizime Peqin sh.a. Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Peqin" sh.a. të paguajë shumën 960 000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

**Kjo çështje nuk është shqyrtuar përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë gjatë vitit 2018.**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

Gjatë vitit 2019 Enti Rregullator i Ujit ishte pjesë e 12 proceseve gjyqësore, 9 prej të cilave të iniciuara nga vetë ERRU me objekt shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të pagesës rregullatore nga ana e shoqërive ujësjellës kanalizime. Aktualisht çështjet gjyqësore janë në fazat si më poshtë:

1. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë sh.a. Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit RAPORTI VJETOR ERRU 2019 21 Palë e paditur: Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë sh.a. Objekti: Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë sh.a" të shlyejë shumën 778 200 lekë si një detyrim i prapambetur kontraktual.

**Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos që shoqëria UK Rrogozhinë sh.a t'i paguajë ERRU shumën 778 200 lekë. Ky vendim ka marrë formë të prerë.**

2. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjellës Kanalizime Krujë sh.a. Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit Palë e paditur: Ujësjellës Kanalizime Krujë sh.a. Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Krujë" sh.a. të paguajë shumën prej 1,386,200 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual. Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos që shoqëria UK Krujë sh.a t'i paguajë ERRU shumën 1,386,200 lekë.

3. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjellës Kanalizime Kurbin (Laç) sh.a. Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit Palë e paditur: Ujësjellës Kanalizime Kurbin sh.a. Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Kurbin" sh.a. të paguajë shumën 2,000,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

**Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Kurbin dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos që shoqëria UK Kurbin sh.a t'i paguajë ERRU shumën 2,000,000 lekë. Ky vendim ka marrë formë të prerë.**

4. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a. Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit Palë e paditur: Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a. Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a. të paguajë shumën 1,557,500 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

**Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos që shoqëria UK Dibër sh.a t'i paguajë ERRU shumën 1,557,500 lekë. Ky vendim ka marrë formë të prerë.**

5. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a. Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit Palë e paditur: Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a. RAPORTI VJETOR ERRU 2019 22 Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a. të paguajë shumën 3,220,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

**Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Pogradec dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos që shoqëria UK Pogradec sh.a t'i paguajë ERRU shumën 3,220,000 lekë. Ky vendim ka marrë formë të prerë.**

6. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjellës Kanalizime Tepelenë sh.a. Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit Palë e paditur: Ujësjellës Kanalizime Tepelenë sh.a. Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Tepelenë" sh.a. të paguajë shumën 1,376,150 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

**Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos që shoqëria UK Tepelenë sh.a t'i paguajë ERRU shumën 1,376,150 lekë. Ky vendim ka marrë formë të prerë.**

7. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjellës Ura Vajguore sh.a. Palë paditëse: Enti Rregullator i Ujit Palë e paditur: Ujësjellës Kanalizime Ura Vajguore sh.a. Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Ura Vajguore" sh.a. të paguajë shumën 472,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

**Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos që shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Ura Vajgurore sh.a t'i paguajë ERRU shumën 472,000 lekë. Ky vendim ka marrë formë të prerë.**

8. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Kanalizime Peqin sh.a. Pala Paditëse: Enti Rregullator i Ujit Palë e paditur: Ujësjetllës Kanalizime Peqin sh.a. Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Peqin" sh.a. të paguajë shumën 960,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual. Kjo çështje është në shqyrtim nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e cila nuk ka dhënë akoma vendimin përfundimtar.

**Kjo çështje gjithashtu është aktualisht në shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë në lidhje me kompetencën lëndore të dërguar nga vetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.**

9. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Selenicë sh.a. Pala Paditëse: Enti Rregullator i Ujit Pala e Paditur: Ujësjetllës Kanalizime Selenicë sh.a.; Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjetllës Selenicë" sh.a. të paguajë shumën 351,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

**Kjo çështje është në shqyrtim nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila nuk ka dhënë akoma vendimin përfundimtarë.**

10. Komiteti shqiptarë i Helsinkit – Enti Rregullator i Ujit Pala Paditëse: Komiteti Shqiptarë i Helsinkit Pala e Paditur: 1. Ujësjetllës Kanalizime Tiranë; 2. Këshilli Bashkiak, Tiranë; 3. Komisioni (Këshilli) Kombëtar Rregullatorë, Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura; Person i tretë: 1. Bashkia Tiranë; 2. Avokatura e Shtetit; Objekti:- Konstatimin absolutisht të pavlefshëm të: Propozimit për rritjen e tarifave të ujit, drejtuar Entit Rregullatorë të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për rishikimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura nr. prot 13132, datë 29.06.2017 dhe shkresën me nr. prot 14275, datë 20.07.2017 me lëndë "Kërkohet mendimi i Këshillit Bashkiak për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm"; Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 79, datë 26.07.2017 "Për dhënie mendimi për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm"; Vendimit e Këshillit Kombëtar Rregullatorë, Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 47, datë 07.11.2017, "Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a." Rregullimin nga gjykata të pasojave të derivuara nga aktet e përmendura më sipër (absolutisht të pavlefshme) Ndalimi për të ardhmen i efekteve (pasojave) të akteve administrative të sipërcituara, absolutisht të pavlefshme.

**Kjo çështje është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u vendos rrëzimi i kërkesë padisë.**

11. Aida Gojani - Enti Rregullator i Ujit Palë paditëse: Aida Gojani Palë e paditur: Enti Rregullator i Ujit Objekti: Detyrimi i palës së paditur Enti Rregullator i Ujit që të paguajë shpërblimin për vjetërsi në punë për periudhën 21.08.2006 deri më 03.08.2014 periudhë gjatë së cilës kam ushtruar detyrën e Anëtarit të Komisionit Kombëtarë të Entit Rregullator të Ujit në masën e 4 pagave mujore referuar pagës mujore në momentin e përfundimit të marrëdhënies së punës e cila është 146,150 lekë.

**Kjo çështje është gjykuar gjatë vitit 2019 pranë Gjykatës Administrative të Apelit duke vendosur pranimin e kërkesë – padisë dhe detyrimin e ERRU të paguajë 4 paga për vjetërsi në punë. Ky vendim ka marrë formë të prerë.**

Kjo çështje është gjithashtu në shqyrtim nga ana Gjykatës së Lartë Tiranë e cila nuk ka dhënë akoma vendimin përfundimtar.

12. Luena Brekofca - Enti Rregullator i Ujit Palë Paditëse: Luena Brekofca Palë e Paditur: Enti Rregullator i Ujit Objekti: 1. Shfuqizim i vendimit nr.15, datë 25.03.2019 "Për zgjidhjen e Kontratës Individuale të Punës"; 2. Detyrimin e palës së paditur të paguajë dëmshpërblimin me 12 muaj pagë pune, për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara , përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë; 3. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 3 muajve për mos respektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

punës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi page; 4. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 2 muajve për mos respektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë; 5. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e një 15 ditëshi për çdo vit vjetërsi në punë, konkretisht 9 vjet vjetërsi në punë, e barabartë me 4 paga e gjysëm shpërblim, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;

**Kjo çështje është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila nuk ka dhënë akoma vendimin përfundimtar.**

Gjatë vitit 2020 Enti Rregullator i Ujit është pjesë e proceseve gjyqësore në fazat si më poshtë:

1. Luena Brekofca - Enti Rregullator i Ujit Palë Paditëse: Luena Brekofca Palë e Paditur: Enti Rregullator i Ujit Objekti: 1. Shfuqizim i vendimit nr.15, datë 25.03.2019 "Për zgjidhjen e Kontratës Individuale të Punës"; 2. Detyrimin e palës së paditur të paguajë dëmshpërblimin me 12 muaj pagë pune, për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara , përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë; 3. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 3 muajve për mos respektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi page; 4. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 2 muajve për mos respektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë; 5. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e një 15 ditëshi për çdo vit vjetërsi në punë, konkretisht 9 vjet vjetërsi në punë, e barabartë me 4 paga e gjysmë shpërblim, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;

**Kjo çështje është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesë – padisë. Ky vendim deri më sot nuk ka marrë formën e prerë.**

2. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Selenicë sh.a. Pala Paditëse: Enti Rregullator i Ujit Pala e Paditur: Ujësjetllës Kanalizime Selenicë sh.a.; Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjetllës Selenicë" sh.a. të paguajë shumën 351,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

**Kjo çështje është në shqyrtim nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila nuk ka dhënë akoma vendimin përfundimtarë.**

3. Enti Rregullator i Ujit - Ujësjetllës Kanalizime Peqin sh.a. Pala Paditëse: Enti Rregullator i Ujit Palë e paditur: Ujësjetllës Kanalizime Peqin sh.a. Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Peqin" sh.a. të paguajë shumën 960,000 lekë ndaj Entit Rregullator të Ujit, si detyrim i pa përmbushur kontraktual. Kjo çështje është në shqyrtim nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e cila nuk ka dhënë akoma vendimin përfundimtar.

**Kjo çështje gjithashtu është aktualisht në shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë në lidhje me kompetencën lëndore të dërguar nga vetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.**

## 8.2 INSPEKTIMET

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar 12 (dymbëdhjetë) inspektive pranë shoqërive ujësjetllës kanalizime dhe si rezultat i tyre u konstatua dhe u morën masat si më poshtë:

1. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Divjakë sh.a. ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë. Për këto arsye ndaj UK Divjakë u mor masa administrative gjobë në shumën 300 000 lekë për ushtrimin e veprimtarisë pa licencë .

2. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës sh.a. nuk zbatonte vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 74, datë 19.10.2018 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik të sh.a. ujësjetllës kanalizime Vau Dejës", por me një Vendim të kundraligjshëm të këshillit bashkiak vazhdonte të aplikonte tarifën e mëparshme. Kjo situatë u konstatua dy (2) muaj para zgjedhjeve lokale të vitit 2019. Për këtë arsye ERRU vendosi që shoqëria UK Vau Dejës të aplikonte vendimin e dhënë nga Komisioni Kombëtar Rregullator duke kundërshtuar vendimin e kundraligjshëm të këshillit bashkiak.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

3. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Pustec sh.a. ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë. Kjo Shoqëri gjithashtu ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura me tarifa të pa miratuara nga ERRU.

4. Për Shoqërinë UK Pustec bazuar kryesisht në gjendjen e vështirë ekonomike të saj u vendos ti lihet afati deri në 31 dhjetor 2020 për pajisjen me licencë dhe të aplikojë për tarifa pranë ERRU dhe të përdorë tarifa të miratuara nga kjo e fundit.

5. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Fushë Arrëz sh.a. ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë. Kjo Shoqëri gjithashtu ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura me tarifa të pa miratuara nga ERRU. Për Shoqërinë UK Fushë Arrëz bazuar kryesisht në gjendjen e vështirë ekonomike të saj u vendos që të bëhet licencimi i saj për vetëm zonën ekzistuese (jo të riorganizuar). Gjithashtu kësaj shoqërie i lihet afati 1 (një) vjeçar për ri licencim sipas VKM nr. 63, datë 27.01.2016 (re riorganizuar) dhe të aplikojë për tarifa pranë ERRU dhe të përdorë tarifa të miratuara nga kjo e fundit.

6. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Fier ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë, si dhe nuk ka paguar detyrimet financiare të prapambetura ndaj ERRU-së. Pengesa kryesore e Shoqërisë për liçensim ka qenë mos pajisja me Akt Miratimin Higjieno Sanitar nga pengesa burokratike dhe qëndrime të ngurtësuara nga Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik për lëshimin e këtij akti.

Për Shoqërinë UK Fier u vendos ri-inspektimi i kësaj shoqërie brenda 6 (gjashtë) muajve me qëllim zgjidhjen e problemit të Akt Miratimit Higjieno Sanitar, ndërsa për pagesat rregullatore u arrit firmosja e një marrëveshje me ERRU-në për pagesat e prapambetura dhe brenda një periudhe kohe të arsyeshme me këste mujore.

7. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Përmet ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë që nga data 13.01.2017, si dhe kishte detyrime financiare të prapambetura të pagesës rregullatore. Arsyet e mos licencimit edhe në këtë rast ishin për shkak të mos marrjes së Akt Miratimit Higjieno Sanitar nga Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik me arsyetimin se shoqëria po kryente investime në rrjetin e brendshëm të qytetit, ndërsa për mos pagesën rregullatore justifikimi ishte për shkak të gjendjes së dobët financiare të shoqërisë. Gjithsesi pas Inspektimit shoqëria arriti të likuidonte gjysmën e detyrimit financiarë të prapambetur. Për këtë shoqëri u vendos ri inspektimi i saj brenda 6 (gjashtë) muajve me qëllim realizimin e detyrave të lëna në raportin e inspektimit.

8. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Bulqizë ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë mbas mbarimit të afatit të saj me datë 17.07.2018. Gjithashtu kjo shoqëri nuk është riorganizuar ende sipas reformës pasi nuk ka kryer vlerësimin e asetëve si dhe nuk ka marrë akoma në dorëzim nga bashkia Njësinë Administrative të Krastës e cila më parë ka funksionuar si ndërmarrje UK dhe ka shumë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve. Gjithashtu problematik për këtë shoqëri është edhe mos pajisja me akt miratim Higjieno – Sanitar për zonat e reja të shërbimit. Për sa më sipër pas detyrave të lëna nga ERRU u vendos ri inspektimi i kësaj shoqërie brenda 6 (gjashtë) muajve me qëllim realizimin e detyrave të lëna në raportin e inspektimit.

9. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë që mbas mbarimit të afatit të saj me datë 01.09.2000, si dhe ofron shërbimet me tarifa të pa miratuara nga ERRU. Arsyet e mos licencimit të kësaj shoqërie kanë qenë të shumta si pasojë e akumulimit të problematikave të ndryshme në vite. Shoqëria nuk arrinte të regjistrohej në QKB sepse nuk kishte historik të Këshillave Mbikëqyrëse (kopje të dokumentave të identifikimit të anëtarëve) dhe të bilanceve financiare ndër vite, si edhe detyrime të mbartura për sigurimet e punonjësve ndër vite, detyrime ndaj OSSHE-së dhe të tretëve. Gjithashtu problematik për këtë shoqëri ishte edhe pajisja me akt miratimet higjieno sanitare, kjo si pasojë e burokracive nga Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, çështje e cila ishte adresuar deri në Kryeministri nga drejtuesi i shoqërisë. Pas detyrave të lëna nga ERRU u vendos ri inspektimi i kësaj shoqërie brenda 6 (gjashtë) muajve me qëllim realizimin e detyrave të lëna në raportin e inspektimit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

10. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Këlcyrë edhe pse ofronte prej vitesh shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura nuk ka patur licencë të vlefshme nga ERRU pasi nuk kishte arritur asnjëherë të plotësonte dokumentacionin përkatës për licencim edhe pse me këtë shoqëri nga ana e ERRU-së janë zhvilluar takime të shumta në këtë drejtim. Arsyet e mos licencimit të shoqërisë ishin të shumta pasi shoqëria nuk ishte riorganizuar akoma sipas reformës dhe nuk kishte bërë regjistrimet përkatëse në QKB, mungesa e gjetjes së një drejtuesi teknik të kualifikuar si dhe mungesa e Akt Miratimit Higjiëno sanitarë pasi sipas Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik nuk plotësonte kushtet për marrjen e saj për të gjithë zonën e shërbimit. Gjatë inspektimit nga shoqëria u bënë prezent dokumenta ku u informuam se kishin avancuar në plotësimin e dokumentacionit përkatës për licencim. Nisur nga kjo për shoqërinë UK Këlcyrë nga ERRU u vendos ri inspektimi i saj brenda 6 (gjashtë) muajve me qëllim realizimin e detyrave të lëna në raportin e inspektimit.

11. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Selenicë ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë pas përfundimit të afatit të saj me datë 30.04.2016 si dhe kishte detyrime financiare të prapambetura të pagesës rregullatore për të cilat ka edhe një proces të hapur gjyqësorë me ERRU-në. Arsyet e mos licencimit edhe për këtë shoqëri kanë qenë të ndryshme si mos përditësimi i QKB dhe kalimi në një nivel administrimi, shtyrja e afateve të Këshillit të Administrimit, vlerësimi dhe inventarizimi i aseteve për zonat e reja sipas reformës si dhe borxhet e mëdha që kjo shoqëri mbart si pasojë e një situatë shumë të rënduar financiare. ERRU gjatë kësaj kohe ka zhvilluar një sërë takimesh me këtë shoqëri me praninë edhe të kryetarit të bashkisë së saj ku janë informuar mbi detyrimet që ka shoqëria UK Selenicë për licencim dhe zbatimin e VKM nr.63 për riorganizimin e shoqërive UK. Në përfundim për shoqërinë UK Selenicë u vendos aplikimi i saj për licencim për zonën ekzistuese të shërbimit dhe ri inspektim i saj brenda 6 muajve me qëllim realizimin e detyrave të lëna në raportin e inspektimit. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë pas përfundimit të afatit të saj me datë 05.10.2018. Kjo për shkak se shoqëria nuk arrin të pajiset me Akt Miratimin Higjiëno Sanitar. Shoqëria pretendon se janë plotësuar të gjitha dokumentat e nevojshme për marrjen e akt miratimit higjiëno sanitar, por nuk kanë marrë asnjë përgjigje nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor. Kjo e vërtetuar edhe me shkresat përcjellëse të cilat u bënë prezent gjatë inspektimit. Në këto kushte u vendos ri inspektimi i kësaj shoqërie brenda 6 (gjashtë) muajve me qëllim realizimin e detyrave të lëna në raportin e inspektimit.

12. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Elbasan ofronte shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë mbas mbarimit të afatit të saj me datë 25.11.2018. Arsyet e mos aplikimit të kësaj shoqërie për licencim pranë ERRU-së ishin si rezultat i mos riorganizimit të saj sipas reformës, pasi kjo shoqëri duhej të bashkohej me shoqërinë Elbasan Fshat. Proces ky që ishte drejt përfundimit dhe u konstatua në momentin e inspektimit. Për Shoqërinë UK Elbasan nga ERRU u vendos ti lihet një afat 2 (dy) mujorë në lidhje me përfundimin e procesit të licencimit. Inspektimet e realizuara patën efekt pozitiv në drejtim të përmbushjes së detyrimeve nga ana e shoqërive UK të detyrave të lëna nga grupet e inspektimit, ku si rezultat i tyre vlen të theksohet licencimi i disa shoqërive të cilat prej vitesh operonin pa një licencë të miratuar nga ERRU, si UK Fushë Arrëz, Këlcyrë dhe Mallakastër gjithashtu u licencuan edhe shoqëritë UK Elbasan, Përmet dhe Fier. Problematikë kryesore e mos licencimit të shoqërive UK mbetet rishikimi i bazës ligjore në lidhje me kërkesat dhe kriteret për pajisjen e shoqërive UK me Akt Miratimin Higjiëno Sanitar.

### 8.3 ANKESA

VITI 2018

1. Pala Ankuese: Konsumatore Familjare

Pala e Ankimuar: UK Tiranë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

**Objekti i ankesës:** Refuzimi i lidhjes së kontratës për shërbime ujësjellës kanalizime në emër të saj dhe furnizimin me ujë të pijshëm

**Konkluzioni:** Rekomandim për lidhjen e kontratës sipas aktit të pronësisë dhe të drejtës për lidhjen me sistemin e furnizimit me ujë

**2.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Sigurimin e furnizimit me ujë nëpërmjet pikës së lidhjes me rrjetin publik të furnizimit me ujë të pijshëm.

**Konkluzioni:** Rekomandim për lidhjen me sistemin e furnizimit me ujë sipas pikës së lidhjes

**3.Pala Ankuese:** Konsumator Privat [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Mbylljen e kontratave të ujit Nr. 149353 -1 dhe Nr. 149352 - 1.

**Konkluzioni:** Marrjen e masave për mbylljen e kontratave të ujit Nr. 149353 -1 dhe Nr. 149352 - 1 të shoqërisë [REDAKTUAR] dhe bashkëpunimi ngushtësisht me këtë shoqëri për të zgjidhur përfundimisht kërkesën e tyre.

**4.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Anullim i faturave të lëshuara pas muajit Janar 2009 dhe kamatëvonesat përkatëse.

**Konkluzioni:** Rekomandim për rishikimin e ankesës dhe anulimin e faturimit të kryer në kushtet kur nuk ka pasur një objekt banimi (*objekt i prishur për arsye rindërtimi*) por është kryer faturim aforfë.

**5.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Shkodër

**Objekti i ankesës:** Mbifaturim në faturat e ujit.

**Konkluzioni:** Konsumatori ka njohur detyrimin duke nënshkruar një akt marrëveshje, rekomanduar nga ERRU depozitimi i kërkesës për instalim ujëmatësi

**6.Pala Ankuese:** Konsumatore Familjare [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Mosnjohje detyrimi dhe kërkesë për lidhje kontrate në emër të saj

**Konkluzioni:** Rishikimi i ankesës dhe kryerja e verifikimeve të duhura nga UKT mbi detyrimet e pretenduara si dhe lidhja e kontratës në emër të konsumatores

**7.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Durrës

**Objekti i ankesës:** Mosnjohje detyrimi nga viti 2008

**Konkluzioni:** Ankimi në fjale është trajtuar me një vendim të Gjykatës së Shkalles së Parë Durrës dhe ka marrë formë të prerë. Rekomandim shoqërisë për instalimin e ujëmatësit këtij konsumatori.

**8.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Fier

**Objekti i ankesës:** Faturim nga UK Fier duke mos pasur një kontratë për shërbimin ujësjellës kanalizime.

**Konkluzioni:** Rishikimi i ankesës dhe faturimit aforfë dhe rekomandim shoqërisë për instalimin e ujëmatësit këtij konsumatori.

**9.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Mos njohje të detyrimeve ndaj UKT-së.

**Konkluzioni:** Rishikimi i ankesës në frymën e gjetjes së një zgjidhje të përbashkët me konsumatorin mbi vlerën dhe shlyerjen e detyrimit.

**10.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Mos njohje të detyrimeve që ka ndaj UKT-së.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

**Konkluzioni:** Shlyerja e detyrimeve nga viti 2008 periudhë në të cilën konsumatori ka banuar në banesën vjetër dhe ka përfutuar shërbimin ujësjellës kanalizime. Për periudhën pas vitit 2009 rekomanduar vijimi e ankimimit me objekt anulimin e faturave tatimore pranë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë.

**11.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Anullimi e faturave aforfe për vitin 2015.

**Konkluzioni:** Konsumatori ka lidhur një akt marrëveshje me shoqërinë UKT mbi njohjen e detyrimit si dhe shlyerjen e debisë me këste.

**12.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Vlorë

**Objekti i ankesës:** Kundërshtim i faturave aforfe

**Konkluzioni:** Konsumatori ne muajin Maj 2018 është faturuar sipas certifikatës familjare dhe me pas i është instaluar ujëmatësi

**13.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Kavajë

**Objekti i ankesës:** Probleme te furnizimit me ujë

**Konkluzioni:** Shoqëria ka përfunduar procesin e investimit për rrjetin dhe aktualisht pallati i konsumatorit furnizohet rregullisht me ujë.

**14.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Mosngarkim i kostove të ujëmatësit

**Konkluzioni:** Konsumatorit ju ndërrua ujëmatësi pa te drejte dhe i është hequr kostoja e ujëmatësit nga fatura

**15.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Fier

**Objekti i ankesës:** Anullimin e faturave aforfe

**Konkluzioni:** Paraqitje pranë UK Fier për të rihapur diskutimin dhe në frymën e bashkëpunimit të gjendet një zgjidhje mbi detyrimet e kontratës Nr. 2100293.

**16.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Tirane

**Objekti i ankesës:** Mbifaturim në faturën e ujit të muajit Mars 2018

**Konkluzioni:** Sipas verifikimit te shoqërisë faturimi është bërë në mënyrë të rregullt, progresive dhe leximi është kryer sipas gjendjes faktike të ujëmatësit.

**17.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Elbasan

**Objekti i ankesës:** Mbifaturim në periudhën Shtator 2015- Shkurt 2017

**Konkluzioni:** Konsumatori do te faturohet aforfe në masën 13.5 m<sup>3</sup> në muaj referuar certifikatës familjare deri në zgjidhjen përfundimtare të problemit dhe instalimit të ujëmatësit.

**18.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Tirane

**Objekti i ankesës:** Saktësimi i kontratës që i përket banesës së tij

**Konkluzioni:** Rekomandim të dyja palëve per formalizimin nga ana ligjore të marrëdhënies së tyre duke nënshkruar një kontratë për shërbime ujësjellës kanalizime

**19.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Tirane

**Objekti i ankesës:** Saktësimi i kontratës që i përket banesës së tij

**Konkluzioni:** Rekomandim të dyja palëve per formalizimin nga ana ligjore të marrëdhënies së tyre duke nënshkruar një kontratë për shërbime ujësjellës kanalizime

**20.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDAKTUAR]

**Pala e Ankimuar:** UK Fushe Arrëz

**Objekti i ankesës:** Faturim për një shërbim të pa ofruar



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

**Konkluzioni:** Konsumatori duhet të ndërmarrë të gjitha hapat për të lidhur objektet në mënyrën e duhur me sistemin e kanalizimeve si dhe të lejojë shoqërinë UK Fushë Arrëz të kryejë shërbimin e largimit e ujërave të ndotura;

**21.Pala Ankuese:** Konsumatore Familjare [REDACTED]

**Pala e Ankimuar:** UK Kruje

**Objekti i ankesës:** Mos marrja e masave për heqjen elektropompave

**Konkluzioni:** ERRU nuk ka kompetencën për vijimin e trajtimit të ankesës së [REDACTED] sepse administrimi i ambienteve publike i takojnë me kompetencë Bashkisë Krujë.

### VITI 2019

**1.Pala Ankuese:** Konsumator Privat [REDACTED]

**Pala e Ankimuar:** UK Tirane

**Objekti i ankesës:** Mos pezullim i kontratave të furnizimit me ujë midis [REDACTED] sh.p.k dhe UK Tiranë.

**Konkluzioni:** Gjate shqyrtimit te ankimimit, kjo çështje kaloi ne proces gjyqësor ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane

**2.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDACTED]

**Pala e Ankimuar:** UK Tirane

**Objekti i ankesës:** Ankim ndaj ndërprerjeve të pa njoftuara të furnizimit me ujë

**Konkluzioni:** Pas verifikimit ne terren, te gjitha palët pjesëmarrëse, ERRU, UKT dhe Konsumatori, ndërprerja dhe cilësia e ujit vinte nga brenda kompleksit rezidencial

**3.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDACTED]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Anullim të faturimit aforfe

**Konkluzioni:** Të rekomandojë një zgjidhje me mirëkuptim mes palëve për të rishikuar faturimin e kryer për kontratën Nr. 830239 nga periudha Mars 2016 deri në Janar 2018.

**4.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDACTED]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Anullim të faturimit aforfe dhe pezullim të kontratës

**Konkluzioni:** Të rekomandojë UKT-në mbi mundësinë e rishikimit të faturimit të kryer për kontratën 024267- 1 dhe gjetja e një zgjidhje te përbashkët.

**5.Pala Ankuese:** Konsumatore Familjare [REDACTED]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Ankesë mbi veprimet e padrejta të UKT dhe anulimin e masës administrative

**Konkluzioni:** Rishikimi (shfuqizimi) i Vendimit Nr. 9, datë 08.04.2019 dhe fillimi i procedurave për ndryshimin e kategorisë për kontratën Nr. 132573 nga konsumator familjarë në konsumatorë privat.

**6.Pala Ankuese:** Konsumatore Familjare [REDACTED]

**Pala e Ankimuar:** UK Vlorë

**Objekti i ankesës:** Mungesë e furnizimit me ujë

**Konkluzioni:** Komisioni Kombëtar Rregullator nuk konstaton shkelje të ndonjë dispozite ligjore nga UK Vlorë për të vijuar më tej me trajtimin e ankesës.

**7.Pala Ankuese:** Konsumatore Familjare [REDACTED]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Anullim të faturimit aforfe

**Konkluzioni:** Ti rekomandojë UKT-së mundësinë të rishikojë faturimin e kryer për kontratën Nr. 024267- 1.

**8.Pala Ankuese:** Konsumatore Familjare [REDACTED]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Anullim të faturimit aforfe nga data 16.08.2016

**Konkluzioni:** Ti rekomandojë [REDACTED] të paraqitet pranë zyrave të UKT-së për të gjetur një zgjidhje të përbashkët me UKT-në duke lidhur një akt marrëveshje mbi këtë detyrim të mbartur



## KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

në vite 2008 – Gusht 2016 si dhe të depozitohet kërkesën për instalimin falas të ujëmatësit si dhe ndërrimin e emrit të kontratës.

#### VITI 2020

**1.Pala Ankuese:** Konsumatore Familjare [REDACTED]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Mos zbatim i kërkesës për pezullim kontrate

**Konkluzioni Aktual:** Fillim Procedure për shqyrtimin e ankesës

**2.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDACTED]

**Pala e Ankimuar:** UK Tiranë

**Objekti i ankesës:** Mos njohja e faturimit dhe shpallja e pavlefshme e faturave nga data 25.08.2014.

**Konkluzioni Aktual:** Fillim Procedure për shqyrtimin e ankesës

**3.Pala Ankuese:** Konsumator Familjar [REDACTED]

**Pala e Ankimuar:** UK Elbasan

**Objekti i ankesës:** Mungese e furnizimit te vazhdueshëm me ujë dhe faturim në mënyrë te padrejte”

**Konkluzioni Aktual:** Fillim Procedure për shqyrtimin e ankesës

### ***NË PËRFUNDIM PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES REKOMANDOJMË MARRJEN E MASAVE SI MË POSHTË:***

#### **PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:**

##### **1. Gjetje nga auditimi:**

Për licencimin e personave fizik e juridik u vërejt problematika në lidhje me mos miratimin dhe mos pajisje me aktin Higjieno - Sanitar për të gjithë zonat e shërbimit. Ky veprim ka ndikuar në vonesa të procedurave licencimit dhe të garancisë së sigurisë së shëndetit publik, pasi shoqëritë e Ujësjetës Kanalizime duke mos e pasur këtë licencë deri në momentin e marrjes së saj zhvillojnë aktivitetin normal të tyre, duke mbartur kështu, riskun e kontaminimit të rrjeteve shpërndarëse të ujësjetës.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 25-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

##### **1.1. Rekomandim:**

ERRU në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë duhet të marrin iniciativën për hartimin e akteve të nevojshme ligjore dhe nënligjore për saktësimin e procedurave të lëshimit të Akt Miratimit Higjieno Sanitar për shoqëritë Ujësjetës Kanalizime, dhe të rregullores se Inspektimeve Higjieno Sanitare për sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura. Hartimi i akteve të mësipërme do të shërbejë rritjes së garancisë së sigurisë së shëndetit publik.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

#### **MASAT ORGANIZATIVE**

##### **2. Gjetje nga auditimi:**

Në lidhje me plotësimin e organikës së ERRU-së në zbatim të Vendimit të Kuvendit nr.34/2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura” rezultoi se, deri më 30.04.2020, organika është e paplotësuar me 3 punonjës më pak.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 15-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

#### 2.1. Rekomandim:

ERRU të marrë masat dhe të fillojë procedurat për rekrutimin e stafit në pozicionet vakante sipas strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

#### 3. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi u konstatua se dosjet e procedurave të licensimit të personave fizik e juridik dhe dosjet e përcaktimit të çmimeve dhe tarifave të shitjes së ujit me pakicë dhe shumicë të ujrave të përdorur dhe trajtimit të tyre nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat.

-Dosjet personale të nëpunësve nuk janë inventarizuar, administruar me indeks të veçantë, sipas VKM Nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", Formatit Standard nr.17, ku evidentohen shkresat e fashikujt në veçanti si dhe pasqyrimi kronologjik i numrit të fletëve në dosje.  
(Trajtuar më hollësisht në faqet 15-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### 3.1. Rekomandim:

ERRU të marrë masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve të të gjitha procedurave të licensimit dhe e përcaktimit të çmimeve dhe tarifave dhe dosjeve personale të nëpunësve.

*Në vijimësi*

#### 4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurave të blerjeve të vogla konstatohet se nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël është kërkuar që Operatorët Ekonomik fitues duhet të sjellin mostra për secilin produkt në momentin e paraqitjes në institucion, pra para lidhjes së kontratës së furnizimit. Ky veprim bie në kundërshtim me pikën 8 të Udhëzimit nr. 3 datë 08.01.2018, në të cilin përcaktohet se, "Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël autoriteti kontraktor nuk duhet të kërkojë paraqitjen e mostrave të mallit objekt prokurimi, pasi verifikimi i cilësisë së mallit bëhet në momentin e marrjes së mallit në dorëzim"

(Trajtuar më hollësisht në faqet 33-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### 4.1. Rekomandim:

Nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, të merren masa që në çdo procedurë prokurimi për blerjet e vogla, në dokumentet standarte të tenderit të vendoset verifikimi i cilësisë së mallit të bëhet në momentin e marrjes së mallit në dorëzim.

*Në vijimësi*

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**



## ANEKSI 1

### SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

A. Audituesi duhet të shprehë një **opinion të pamodifikuar** mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se, transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.

**1. Një opinion i pakualifikuar** (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
- (b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
- (c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe
- (d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

**1.1 Opinioni me rezerve.** Opinioni me rezerve do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

### B. Audituesi e modifikon opinionin, duke shprehur:

**1. Opinioni i kualifikuar.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

**2. Opinioni negativ (kundërshtues).** Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion me rezerve në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinionit qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

**3. Refuzim i opinionit.** Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.



## ANEKSI II

### QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Gjatë procesit të planifikimit, janë mblidhur informacion për subjektin në mënyrë që të vlerësohet risku dhe të përcaktohen nivelet e materialitetit për hartimin e procedurave të auditimit. Evidencat e mbledhura më pas janë vlerësuar si një bazë për formimin e përfundimeve dhe për qëllime raportimi. Materialiteti është i rëndësishëm për këtë vlerësim.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe kryqëzimin e tyre me të dhënat e gjeneruara nga databaza e sistemit të Thesarit, në Ministrinë e Financave, si edhe rakordimi në situacionet e Thesarit.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Konkretisht, mbi të dhenat e disponuara u aplikuan:

- teste të detajeve

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik;

- Peshat specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Në kuadër të auditimit të përputhshmërisë, cilësia ose efektiviteti i sistemeve të kontrollit mund të përcaktohet në bazë të nivelit 0,7- 2% të materialitetit nëse auditimi jep siguri të arsyeshme (për shembull, bazuar mbi teste të mjaftueshme kontrolli dhe/ose teste thelbësore):

- kur një dobësi e sistemit nuk sjell gabime material, në këtë rast sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si "efektiv";

- kur gabimet/parregullsitë, të cilat nuk janë parandaluar, zbuluar dhe korrigjuare tejkalojnë pragun e materialitetit prej 2%,; në këto raste, sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si "pjesërisht efektiv" ose "jo efektiv".

Përzgjedhjen e urdhër pagesave sipas *drejtimit nr. 3* të programit të auditimit është bërë duke parë brenda kontekstit të natyrës specifike të shpenzimeve, të cilat mbartin risk, duke marrë në konsideratë dhe faktorët si:

- vlerat e pagesës

- ngjarje apo transaksione të rëndësishme si kontrata të rëndësishme prokurimi, kontrata për investime afatgjatë, të cilat mund të jenë shkas për ndonjë risk më të lartë.

- afati kohor që nga data e urdhër pagesës me datën e faturës së lëshuar për kryerjen e shërbimit, për të analizuar arsyen e këtyre vonesave në ekzekutim, duke kaluar afatin 30 ditorë të parashikuar në legjislacion.

- ekzekutimi i pagesave në lidhje me vendimet e formës së prerë dhe kthimin e tij në titull ekzekutiv, duke marrë parasysh afatin e zgjatjes së pagesës nga vendimi deri në ekzekutimin e pagesës nga institucioni.

Për vitin 2018-2019, masa e mbulimit nga auditimi i urdhër pagesave është 8 urdhër pagesa për 2018 dhe 9 urdhër pagesa për 2019 dhe 2 urdhër pagesa për vitin 2020.

#### **-Mbulimi me auditim i prokurimeve:**

Sa i takon auditimit të prokurimeve nën gjykimin profesional të audituesit, përzgjedhja e prokurimeve u realizua nisur nga peshat specifike e secilës prej tyre ndaj total vlerës vjetore të prokurimeve të realizuara: Peshën më të madhe të prokurimeve e zënë prokurimet me vlerë të vogël. Masa e mbulimit nga auditimi: U audituan 100% e procedurave.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

**-Mbulimi me auditimi i pajisjes me licenca të personave fizik dhe juridik dhe përcaktimi i tarifave të licencimit**

Sa i takon pajisjes me licenca të personave fizik dhe juridik dhe përcaktimi i tarifave të licencimit janë audituar 30 dosje për vitin 2018 dhe vitin 2019

**-Mbulimi me auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave të shitjes së ujit me pakicë dhe shumicë të ujrat e përdorur dhe trajtimit të tyre.**

Sa i takon zbatimit të dispozitave ligjore për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave të shitjes së ujit me pakicë dhe shumicë të ujrat e përdorur dhe trajtimit të tyre u mbuluan me auditim 10 procedura.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT

### ANEKSI III

Tabela nr.1

Nr.	Plotësimi strukturës dhe organikes ne fund te vitit 2018	Plan	Fakt	Dif.F/Pl.
<b>1</b>	<b>KOMISIONI I ERRU SË</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>0</b>
	KRYETARI	1	1	0
	ANËTARE KOMISIONI	4	4	0
	Sekretarja e Komisionit dhe Kryetarit	1	1	0
<b>2</b>	<b>DREJTORIA TEKNIKO - EKONOMIKE</b>	<b>9</b>	<b>9</b>	<b>0</b>
	Drejtor Drejtorie	1	1	0
	<i>Spektori Teknik dhe i Licencave</i>			
	Përgjegjës sektori	1	1	0
	Specialist i rrjeteve inxhinierike të ujësjellësve dhe ITUP	1	1	0
	Specialist i rrjeteve inxhinierike të KUN dhe ITUN	1	1	0
	<i>Spektori Ekonomik dhe i Tarifave</i>			
	Përgjegjës sektori	1	1	0
	Specialist i analizës ekonomiko-financiare	1	1	0
	Specialist i analizës së aseteve dhe investimeve	1	1	0
	<i>Spektori Monitorimit dhe Performancës</i>			
	Specialist i performancës operative dhe cilësisë së shërbimit	1	1	0
	Specialisti i performancës ekonomiko-financiare	1	1	0
<b>3</b>	<b>DREJTORIA JURIDIKE DHE KONSUMATORI</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>2</b>
	Drejtor Drejtorie	1	0	1
	<i>Spektori Juridik</i>			
	Specialist ligjor	2	2	0
	<i>Spektori Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorin</i>			
	Specialist i trajtimit të ankesave	1	1	0
	Specialist i marrëdhënieve me publikun	1	0	1
<b>4</b>	<b>DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE</b>	<b>8</b>	<b>6</b>	<b>2</b>
	Drejtor Drejtorie	1	0	1
	<i>Spektori Burimeve Njerëzore dhe Financiare</i>			
	Specialist i burimeve njerëzore	1	0	1
	Specialist i financës	1	1	0
	<i>Spektori i Shërbimeve</i>			
	Specialist IT	1	1	0
	Specialist protokoll-arkiv	1	1	0
	<i>Punonjës mbështetës</i>			
	Shofer	2	2	0
	Magaznier dhe Sanitare	1	1	0
	<b>TOTALI</b>	<b>28</b>	<b>24</b>	<b>4</b>



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT**

**Tabela nr.2**

Nr.	Plotësimi strukturës dhe organikes ne fund te vitit 2019	Plan	Fakt	Dif.F/Pl.
<b>1</b>	<b>KOMISIONI I ERRU-SË</b>	<b>6</b>	<b>5</b>	<b>1</b>
	KRYETARI	1	1	0
	ANËTARE KOMISIONI	4	3	1
	Sekretarja e Komisionit dhe Kryetarit	1	1	0
<b>2</b>	<b>DREJTORIA TEKNIKO-EKONOMIKE</b>	<b>9</b>	<b>8</b>	<b>1</b>
	Drejtor Drejtorie	1	1	0
	<i>Sektori Teknik dhe i Licencave</i>			
	Përgjegjës sektori	1	1	0
	Specialist i rrjeteve inxhinierike të ujësjellësve dhe ITUP	1	1	0
	Specialist i rrjeteve inxhinierike të KUN dhe ITUN	1	1	0
	<i>Sektori Ekonomik dhe i Tarifave</i>			
	Përgjegjës sektori	1	1	0
	Specialist i analizës ekonomiko-financiare	1	0	1
	Specialist i analizës së aseteve dhe investimeve	1	1	0
	<i>Sektori Monitorimit dhe Performancës</i>			
	Specialist i performancës operative dhe cilësisë së shërbimit	1	1	0
	Specialisti i performancës ekonomiko-financiare	1	1	0
<b>3</b>	<b>DREJTORIA JURIDIKE DHE KONSUMATORIT</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>1</b>
	Drejtor Drejtorie	1	0	1
	<i>Sektori Juridik</i>			
	Specialist ligjor	2	2	0
	<i>Sektori Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorin</i>			
	Specialist i trajtimit të ankesave	1	1	0
	Specialist i marrëdhënieve me publikun	1	1	0
<b>4</b>	<b>DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHËTETËSE</b>	<b>8</b>	<b>7</b>	<b>1</b>
	Drejtor Drejtorie	1	1	0
	<i>Sektori Burimeve Njerëzore dhe Financiare</i>			
	Specialist i burimeve njerëzore	1	0	1
	Specialist i financës	1	1	0
	<i>Sektori i Shërbimeve</i>			
	Specialist IT	1	1	0
	Specialist protokoll-arkiv	1	1	0
	<i>Punonjës mbështetës</i>			
	Shofer	2	2	0
	Magaznier dhe Sanitare	1	1	0
	<b>TOTALI</b>	<b>28</b>	<b>24</b>	<b>4</b>



**KONTROLLI I LARTË I SHITIT**  
**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË ENTIN RREGULLATOR TË UJIT**

**Tabela nr.3**

Nr.	Plotësimi strukturës dhe organikes ne fund te vitit 30/04/2020	Plan	Fakt	Dif.F/Pl.
<b>1</b>	<b>KOMISIONI I ERRU-SE</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>0</b>
	KRYETARI	1	1	0
	ANËTARE KOMISIONI	4	4	0
	Sekretarja e Komisionit dhe Kryetarit	1	1	0
<b>2</b>	<b>DREJTORIA TEKNIKO-EKONOMIKE</b>	<b>9</b>	<b>8</b>	<b>1</b>
	Drejtor Drejtorie	1	1	0
	<i>Spektori Teknik dhe i Licencave</i>			
	Përgjegjës sektori	1	1	0
	Specialist i rrjeteve inxhinierike të ujësujllësve dhe ITUP	1	1	0
	Specialist i rrjeteve inxhinierike të KUN dhe ITUN	1	1	0
	<i>Spektori Ekonomik dhe i Tarifave</i>			
	Përgjegjës sektori	1	1	0
	Specialist i analizës ekonomiko-financiare	1	0	1
	Specialist i analizës së aseteve dhe investimeve	1	1	0
	<i>Spektori Monitorimit dhe Performancës</i>			
	Specialist i performancës operative dhe cilësisë së shërbimit	1	1	0
	Specialisti i performancës ekonomiko-financiare	1	1	0
<b>3</b>	<b>DREJTORIA JURIDIKE DHE KONSUMATORII</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>1</b>
	Drejtor Drejtorie	1	0	1
	<i>Spektori Juridik</i>			
	Specialist ligjor	2	2	0
	<i>Spektori Marrëdhënive me Publikun dhe Konsumatorin</i>			
	Specialist i trajtimit të ankesave	1	1	0
	Specialist i marrëdhënive me publikun	1	1	0
<b>4</b>	<b>DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHËTETËSE</b>	<b>8</b>	<b>7</b>	<b>1</b>
	Drejtor Drejtorie	1	1	0
	<i>Spektori Burimeve Njerëzore dhe Financiare</i>			
	Specialist i burimeve njerëzore	1	0	1
	Specialist i financës	1	1	0
	<i>Spektori i Shërbimeve</i>			
	Specialist IT	1	1	0
	Specialist protokoll-arkiv	1	1	0
	<i>Punonjës mbështetës</i>			
	Shofer	2	2	0
	Magaznier dhe Sanitare	1	1	0
	<b>TOTALI</b>	<b>28</b>	<b>25</b>	<b>3</b>